

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5900
E enjte, 10 tetor 2019
çmimi 0.40 €

PËRFAQËSUESI SPECIAL I PRESIDENTIT TË SHBA-SË, RICHARD GRENELL, KA VIZITUAR KOSOVËN | FAQE 4-5

GRENELLI PRET VAZHDIM TË SHPEJTË TË DIALOGUT

I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, shpreson se Kosova dhe Serbia do të takohen shumë shpejt dhe do të gjejnë një

zgjidhje. Pasi ka takuar liderët politikë të Kosovës në Prishtinë, ai ka vlerësuar se një marrëveshje ndërmjet dy shteteve do ta vë themelin për rritje ekonomike dhe do të kon-

EULEX-i: Shqyrtimi i rasteve të profilit të lartë, i ngadalte | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

PDK-SË NUK I NDIHMOI TRANSFORMIMI. ÇKA DUHET TASH?

F. 13

Shkruan: Milazim KRASNIQI



REPLIKË ME NJË MIK AKADEMIK: JA PSE NA DUHEN ZGJEDHJET NË KOSOVË!

Prof. Lisen BASHKURTI



AKTUALE

HARADINAJ: KOSOVA DHE NORVEGJIA KANË NDËRTUAR MARRËDHËNIE TË SHKËLOYERA F. 5

VESELI TAKON KRYETARËT E DEGËVE, PDK-ja DO TË JETË OPOZITË E FUQISHME F. 3

UNDP-ja I DHURON POLICISË SË KOSOVËS SOFTUER PËR SIGURI KIBERNETIKE F. 7

EKONOMI

DISKUTOHET PËR RËNDËSINË E RISHIKIMIT DHE AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE F. 9

BANKA BOTËRORE: NGADALËSOHET RITJJA EKONOMIKE NË EVROPË F. 9

SPORT

CHALLANDESI: DUA MAKSIMUMIN KUNDËR GJIBRALTARIT F. 18

LDK-ja pranon koalicionin me Vetëvendosjen.

FAQE 3

Nënkryetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka deklaruar se nuk ka asnjë alternativë tjetër përveç krijimit të koalicionit qeverisës në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së. Sipas saj, qytetarët janë përcaktuar për qeverinë e re të formuar nga opozita e deridjeshme. Osmani ka thënë se koalicioni LV-LDK ka shumë sfida para vetes, por duhet ta ketë parasysh vetëm interesin e qytetarëve të Kosovës. Edhe nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmir Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se janë të interesuar për të bashkëqeverisur me LDK-në dhe partitë minoritare, përveç Listës Serbe



KQZ-ja vendos për rinumërimin e 313 vendvotimeve

Sipas KQZ-së, 303 vendvotime do t'i nënshtrohen rinumërimit pasi janë evidentuar gabime teknike në formularët në të cilët janë bartur votat, ndërsa në 10 vendvotime të tjera është vërejtur mungesa e votave të kandidatëve të disa fletëve të formularëve të rezultateve si dhe disa mungesa të nënshkrimeve



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERAMBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Phillipsi: Qëndrimi amerikan të mbështetet te realiteti i ri në Kosovë

Analisti amerikan David Phillips thotë se Shtetet e Bashkuara duhet ta përshtatin qëndrimin e tyre ndaj Qeverisë së ardhshme të Kosovës në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës, kurse për rezultatet e zgjedhjeve thotë se është e qartë se demokracia po funksionon në Kosovë dhe brezi i ri i votuesve do ndryshim



WASHINGTON, 9 TETOR - Analisti amerikan David Phillips thotë se edhe Albin Kurti me kalimin e kohës i ka ndryshuar qëndrimet e veta.

Phillips, profesor i Universitetit i Kolumbias, tha për "Zërin e Amerikës" se Shtetet e Bashkuara duhet ta përshtatin qëndrimin e tyre ndaj Qeverisë së ardhshme të Kosovës në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës. Ai tha se ideja e ndryshimit të kufirit ka vdekur dhe kur negociatat me Serbinë të rifillojnë, Kosova do të shkojë në tryezë me një platformë të integritetit territorial.

Për rezultatet e zgjedhjeve në Kosovë, Phillips thotë se është e qartë se demokracia po funksionon në Kosovë dhe brezi i ri i votuesve do ndryshim. "Njerëzit janë të lodhur me kandidatët e vjetër që e ndërtojnë reputacionin gjatë luftës kundër Serbisë. Pra, zgjedhjet shkuan mirë. Ato ishin të lira dhe të drejta. Tani Kosovën e pret puna e madhe e formimit të qeverisë dhe të një qëndrimi ndaj Beogradit për negociatat e ardhshme", tha ai.

David Phillips thotë se është e qartë se Albin Kurti është i respektuar dhe i admiruar nga elektorati. Tani atij i duhet të ndërtojë ura bashkëpunimi dhe

të punojë drejt formimit të një qeverie koalicioni, të komunikojë me përfaqësuesit serbë në Kosovë për mënyrat se si mund të punojë me ta dhe të zhvillojë një qëndrim për negociatat me Beogradin. "Mendoj se fillimisht do të rishikohet zbatimi i 33 marrëveshjeve ekzistuese dhe bazuar tek ajo analizë, do të rekomandohen disa hapa për zbatimin e mëtejshëm të tyre. Një gjë që nuk është në tryezë, është ndryshimi i kufirit. As Albin Kurti dhe asnjëra nga partitë e mëdha nuk e mbështesin. Pra, Qeveria e Kosovës mund të ketë një dialog me Beogradin por dialogu do të jetë për normalizimin brenda kufijve aktualë të Kosovës. Dhe nuk do të jetë në tryezë ndarja", thotë Phillips.

Ai thotë se patjetër që duhet të ketë negociatat për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe të gjithë e mbështesin normalizimin. "Ndryshimi i kufijve ishte një ide e Hashim Thaçit dhe Aleksandar Vuçiqit. Dhe tani i ka ikur koha. Është e vdekur dhe nuk duhet të merremi më me të. Duhet të përqendrohemi t'i bëjmë presion Beogradit që të njohë Kosovën, t'i normalizojë marrëdhëniet, të merret me çështjen e personave të zhdukur, në mënyrë që të dyja

vendet të ecin përpara si fqinjë brenda kufijve të tyre, krah për krah në paqe dhe mirëqenie.

Phillips ka thënë se e njeh prej dekadash Albin Kurtin dhe e ka parë të ndryshojë si person dhe si personalitet politik. "Unë parashikoj që pjekuria e tij të rritet, që ai të vazhdojë të ndryshojë. Ai mbështet një dialog me Beogradin, por duhet të jemi të qartë për agjendën. Ai është kundër ndarjes apo ndryshimit të kufirit. Prandaj unë pres që zyrtarët amerikanë të përshtaten me realitetin. Albin Kurti do të fillojë përpjekjet për formimin e një qeverie. Do t'i duhet të bashkëpunojë me parti të tjera dhe do t'i duhet të merret me marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë dhe me ser-

bët e Kosovës, me Listën Serbe, në mënyrë që të punojmë në mënyrë konstruktive drejt forcimit të një shoqërie të përbashkët që të jetë shumetnike dhe demokratike. Albin Kurti mund të jetë partner i mirë në këtë drejtim: i pakorruptuar, pa pazare të fshehta, nuk ka prapaska. Këtë donin votuesit dhe në Shtetet e Bashkuara, duhet ta pranojmë", tha Phillips.

David Phillips ka thënë se i dërguari i posaçëm për Ballkanin Perëndimor Matthew Palmer dhe i dërguari i posaçëm për dialogun Kosovë-Serbi, Grenell, duhet të ndjekin një strategji të mbështetur në realitet. "Ata nuk do të marrin vendime në Uashington dhe t'i thonë

Qeverisë së Kosovës apo Albin Kurtit çfarë të bëjë. Duhet të ketë një dialog të vërtetë. Kosova është e pavarur dhe sovranë. Duhet gjithashtu ta kuptojmë që votimi i së dielës, ishte një refuzim i planit për ndarje dhe personalisht Hashim Thaçit", ka thënë Phillips. "Votuesve të Kosovës u kishte ardhur në majë të hundës me qeverisjen e tij në vend, që ishte joefektive dhe përgjithësisht e korruptuar. Ishin kundër marrëdhënieve të tij rajonale, dhe lidhjeve të tepruara miqësore me Beogradin. Ata duan një qeveri që do të përfaqësojë interesat e popullit të Kosovës dhe jo interesat e Rusisë apo Serbisë. Është koha të shihet realiteti në sy", ka thënë Phillips.

Rama dhe Zaevi kanë arritur në Beograd, sot takohen me Vuçiqin



PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev kanë arritur në Serbi të mërkurën pasdite përpara takimit trepalësh që mbahet sot (e enjte) me presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, i cili do të përqendrohet në integrimin më të mirë të tregjeve në rajon. Kryeministri Zoran Zaev ka arritur në Serbi, ndërsa sot (e enjte) në Novi Sad, në Pavijonin e oficerëve të Kalasë së Petrovaradinit, do të marrë pjesë

në takimin trepalësh me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama dhe me presidentin e Republikës së Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Siç paralajmëruan nga kabineti i presidentit serb, pas përfundimit të takimit që duhet të fillojë në orën 09:00, tre liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe të Shqipërisë do të drejtohen në medime.

Iniciativa për këtë takim të Vuçiqit, Zaevit dhe Ramës është si rrjedhojë e takimit të tyre në margjinat e Asamblesë së

Përgjithshme të OKB-së në Nju-Jork, nga fundi i muajit të kaluar, kur presidenti serb Vuçiq e konfirmoi takimin, duke paralajmëruar se ata vijnë në Serbi në gjysmën e parë të muajit tetor në takimin dedikuar largimit të barrierave doganore. Ai tha se, me ta e ka iniciuar idenë për largimin e mëtutjeshëm të barrierave të ndryshme për zhvillimin e biznesit në territorin e tri shteteve tona dhe qarkullimin e lirë të mallrave, njerëzve dhe shërbimeve.

LDK-ja pranon koalicionin me Vetëvendosjen

Nënkryetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka deklaruar se nuk ka asnjë alternativë tjetër përveç krijimit të koalicionit qeverisës në mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së. Sipas saj, qytetarët janë përcaktuar për qeverinë e re të formuar nga opozita e deridjeshme. Osmani ka thënë se koalicioni LV-LDK ka shumë sfida para vetes, por duhet ta ketë parasysh vetëm interesin e qytetarëve të Kosovës. Edhe nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Fatmir Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se janë të interesuar për të bashkëqeverisur me LDK-në dhe partitë minoritare, përveç Listës Serbe

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 TETOR - Ndonëse ende nuk janë publikuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është deklaruar pro koalicionit qeverisës me Lëvizjen Vetëvendosjen. Nënkryetarja e LDK-së dhe ish-kandidatja për kryeministre, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se nuk ka alternativë tjetër përveçse qeveria e re të formohet nga opozita e deridjeshme. Ajo ka deklaruar se koalicioni LV-LDK ka shumë sfida para vetes, por duhet ta ketë parasysh vetëm interesin e qytetarëve të Kosovës. "Më në fund, qytetarët, jo vetëm që votuan, por ajo votë ishte thirrje për ndryshim e ndëshkim ndaj qeverisjes së keqe. Qytetarët, po ashtu, përcaktuan qeverinë e re, e cila duhet të përbëhet nga opozita e deridjeshme. Për mua nuk ka asnjë alternativë tjetër. Koalicioni

LDK-VV ka shumë sfida para vetes, por duhet ta ketë vetëm një interes: atë të qytetarëve të Kosovës. Unë do të punoj dhe do t'i shërbej vendit tim, pavarësisht se ku jam. Ashtu siç e kam thënë gjithnjë, në secilën betejë do të jemi së bashku, deri në fund", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".

Më tutje, ajo ka folur për rezultatin e LDK-së në këto zgjedhje, duke thënë se arritja e tij nuk ka qenë e lehtë. Osmani ka falënderuar të gjithë që e kanë përkrahur atë dhe LDK-në të dielën. Sipas saj, LDK-ja një rezultat të tillë nuk e ka pasur që nga viti 2004. "I falënderoj miliona herë, nga thellësia e zemrës, të gjithë që na përkrahën e besuan, si dhe të gjithë aktivistët e veprimtarët që kurrë nuk reshtën së punuari me vetëmohim. Arritëm që të gjithë së bashku, por për një kohë tejet të shkurtër prej vetëm një muaji, ta ringrehim LDK-në në një rezultat që nuk e kishte nga viti 2004. Por,

na mbetet edhe shumë punë për të bërë, edhe shumë sfida për të kaluar, e ato mund t'i kalojmë vetëm së bashku", është shprehur Osmani.

Ndërsa lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se këto ditë do të takohet me liderin Kurti për ta vlerësuar procesin zgjedhor të së dielës dhe mundësitë e bashkëqeverisjes. "Në zgjedhjet e 6 tetorit LDK-ja mori përkrahje të gjerë nga qytetarët tanë. Qytetarët i ndëshkuan ata që qeverisën keq. Në një garë tepër të ngushtë, 50:50, fituesi, LDK-ja apo VV, do të dihet përfundimisht pasi të përfundojë numërimi i plotë i të gjitha votave. Këto ditë, së bashku me kandidatën tonë për kryeministre, znj.

Vjosa Osmani, do të takohemi me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Kurti, për ta vlerësuar procesin zgjedhor dhe mundësitë e bashkëqeverisjes. Do të vazhdojmë aty ku e kemi lënë para fillimit të procesit zgjedhor, duke respektuar vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë të lirë në një proces demokratik zgjedhor, por edhe interesin e LDK-së", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Pro qeverisjes me LDK-në është shprehur edhe Lëvizja Vetëvendosje. Nënkryetarja e kësaj Lëvizje, Fatmir Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se janë të interesuar për të bashkëqeverisur me LDK-në dhe partitë minoritare, përveç Listës Serbe. Ajo ka thënë se pritet

që pas numërimit të të gjitha votave, LV-ja dhe LDK-ja të ulen dhe të bisedojnë për formimin e qeverisë së re, së cilës do t'i prijë kryeministri Albin Kurti. "Jemi duke pritur numërimin e të gjitha votave, por lideri Kurti ka bërë me dije se do ta ftojë partinë që ishte në opozitë, LDK-në. Jemi të prirë që të bisedojmë me ata që kanë qenë në opozitë sepse të tjerët kanë keqëqeverisur dhe e kanë humbur besimin e qytetarëve. Prandaj presim që pas numërimit të të gjitha votave, LV-ja dhe LDK-ja të ulen dhe të bisedojnë për formimin e qeverisë së re, së cilës do t'i prijë kryeministri Albin Kurti. Jemi të interesuar për të bashkëqeverisur me LDK-në dhe partitë minoritare, përveç Listës Serbe", ka theksuar ajo.

Veseli takon kryetarët e degëve, PDK-ja do të jetë opozitë e fuqishme

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të mërkurën ka takuar kryetarët e degëve të PDK-së dhe shefat e shtabeve zgjedhore, për të diskutuar për procesin e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit.

Kryetari Veseli gjatë këtij takimi ka vlerësuar lart angazhimet dhe performancën e degëve dhe aktivistëve që kanë kontribuar në fushatën zgjedhore. Po ashtu, ai ka falënderuar qytetarët për përkrahjen që i kanë dhënë PDK-

së më 6 tetor.

Në këtë takim kryetarët e degëve në mënyrë unanime kanë mbështetur qëndrimin e kryetarit Kadri Veseli që PDK-ja të jetë në opozitë. Gjithashtu, ata kanë theksuar se me angazhimin e mirëfilltë PDK-ja do të jetë opozitë e fuqishme.

Po në këtë takim është thënë se procesi i reformave të brendshme të partisë do të vazhdojë në mënyrë edhe më intensive nëpër të gjitha degët dhe nëndegët e Partisë Demokratike të Kosovës.



Përfaqësuesi special i presidentit të ShBA-së, Richard Grenell, ka vizituar Kosovën

Grenelli pret vazhdim



I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, shpreson se Kosova dhe Serbia do të takohen shumë shpejt dhe do të gjejnë një zgjidhje. Pasi ka takuar liderët politikë të Kosovës në Prishtinë, ai ka vlerësuar se një marrëveshje ndërmjet dy shteteve do ta vë themelin për rritje ekonomike dhe do të kontribuojë për mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Sipas tij, mungesa e marrëveshjes Kosovë - Serbi është pengesa kryesore e investimeve të huaja në Kosovë

Kurti takon përfaqësuesin special të Norvegjisë për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryetari i Lëvizës Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur sot përfaqësuesin special për Ballkanin Perëndimor nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Arne Sannes Bjornstad, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në Kosovë dhe për dialogun Kosovë - Serbi. Sipas njoftimit për medie të LV-së, Bjornstad e ka uruar Kurtin për rezultatit zgjedhor dhe për mbarëvajtjen e zgjedhjeve. "Përfaqësuesi Special për

Ballkanin Perëndimor nga Norvegjia shprehi interesim për zhvillimet politike në Kosovë dhe për dialogun Kosovë - Serbi. Kryetari Kurti e njoftoi se prioritetet e ka forcimin e shtetit në të gjitha fushat, në drejtësi, në ekonomi e në atë sociale. Sa i përket dialogut Kosovë - Serbi, ai tha se duhet t'i nxjerrim mësimet nga e kaluara në mënyrë që dialogu të jetë i përgatitur mirë, me parime të qarta dhe kësaj që jetë solid", është thënë në njoftimin e LV-së.



të shpejtë të dialogut



politikë. Grenell shpreson se Kosova dhe Serbia do të takohen shumë shpejt dhe do të gjejnë një zgjidhje. Sipas një komunikate për medie të zyrës së presidentit të Kosovës, Grenell ka theksuar se një marrëveshje ndërmjet dy shteteve do ta vë themelin për rritje ekonomike dhe do të kontribuojë për mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Kurse presidenti Thaçi ka thënë se Republika e Kosovës do të jetë konstruktive për gjetjen e një zgjedhjeje, e cila do t'i hapë rrugë zhvillimit. "Pjesëmarrja aktive e ShBA-së - për gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - do të jetë përcaktuese", ka thënë Thaçi.

Presidenti Thaçi ka falënderuar ambasadorin Grenell për mbështetjen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë dhënë Republikës së Kosovës në të gjitha periudhat. "Që nga viti 2008 nuk ka pasur kaq vëmendje të ShBA-së për Kosovën", është shprehur presidenti Thaçi, duke shtuar se "kjo shton konfidencën dhe besimin tonë në kërkimin e Marrëveshjes së Paqes me Serbinë".

Në këtë takim, sipas zyrës së presidentit, është thënë se Marrëveshja e Paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë do t'i kontribuonte zhvillimit të Kosovës dhe tërë rajonit.

Pas largimit nga Presidenca, ambasadori Grenell ka shkruar në Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe aty ka pritur në takim liderin e Lëvizës Vetëvendosje, Albin Kurti. Përmes një komunikate për

medie, LV-ja ka bërë me dije se diplomati amerikan e ka uruar Kurtin për fitoren dhe më pas ka dëgjuar qëndrimin e tij për mundësitë e një marrëveshjeje me Serbinë. "Z. Grenell theksoi semungesa e marrëveshjes së Kosovës me Serbinë është pengesa kryesore e investimeve të huaja në ekonominë e Kosovës", është thënë në komunikatën e LV-së.

Kurti ka shprehur falënderimin e tij për rolin dhe mbështetjen e ShBA-së për Kosovën si në luftë, po ashtu edhe në paqe dhe gatishmërinë e tij që si kryeministër i ri i Kosovës ta thellojë bashkëpunimin me ShBA-në. "Ai u pajtua me ambasadorin Grenell që Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik dhe investime të jashtme, por janë disa probleme që i lënë investitorët pa investuar, si: korrupsioni i lartë në qeveri, i cili krijon pasiguri dhe i tremb bizneset; varfëria e përhapur në popullsi, e cila e mban të ulët kërkesën agregate; si dhe qasja e vështirë në financa për bizneset për shkak të kamatave të larta të kredive në banka. Sa i përket dialogut me Serbinë, z. Kurti tha se përmbajtja dhe procesi i marrëveshjes janë më të rëndësishme për qëndrueshmërinë e saj sesa afati kohor për të", është thënë në komunikatën për medie të LV-së, duke shtuar se në fund të takimit bashkëbiseduesit janë pajtuar që sa më shpejt të krijohet qeveria e re në Kosovë. Pas Kurtit, Grenelli ka takuar edhe kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli dhe kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

Pas vizitës në Kosovë, diplomati amerikan pritet ta vizitojë Serbinë, ku do të takohet me zyrtarët e lartë shtetërorë serbë, për të biseduar rreth vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimit të emisarit Grenell me presidentin Thaçi, ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka shkruar për pritjen e diplomatit amerikan. "I dërguari i posaçëm presidencial, Grenell, pret me padurim që të punojë me presidentin Thaçi dhe liderët e tjerë të Kosovës, për të ndihmuar që të arrihen paqja, drejtësia dhe prosperiteti në Kosovë dhe rajon", ka shkruar Kosnett në "Twitter".

Para pak ditësh presidenti amerikan Donald Trump ka emëruar ambasadorin amerikan në Gjermani, Richard Grenell, si të dërguarin e vet të posaçëm për bisedimet e paqes midis Kosovës dhe Serbisë.

Vizitë në Kosovë ka paralajmëruar edhe shefi i ardhshëm i diplomacisë evropiane, Joseph Borrell. Madje në seancën e konfirmimit në Parlamentin Evropian ai ka deklaruar se vizitën e parë si përfaqësues i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri do të bëjë në Kosovë, duke u zotuar se marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë do të jetë ndër prioritetet kryesore të tij. Borrelli ka bërë me dije se nga Kosova pret ta heqë taksën e vënë ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia, ndërsa nga Serbia pret që të ketë angazhim të sinqertë në procesin e dialogut.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 TETOR - I dërguari i posaçëm i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka takuar të mërkurën liderët institu-

cionalë dhe politikë të Kosovës për të biseduar për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi.

Fillimisht, ambasadori amerikan në Berlin ka takuar presidentin e vendit, Hashim Thaçi, më pas, në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ka takuar veçmas liderët e tjetër

Haradinaj: Kosova dhe Norvegjia kanë ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera

PRISHTINË, 9 TETOR - Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka takuar përfaqësuesin special për Ballkanin Perëndimor, Arne Sannes Bjørnstad, nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, me të cilin ka diskutuar mbi dinamikën e ardhshme në mes të dy shteteve dhe për proceset e tjera të rëndësishme për Kosovën. Në profilin e vet në "Facebook", Haradinaj ka shkruar se Norvegjia ka qenë partnere e rëndësishme e Kosovës në

vazhdimësi. "Potencova faktin se Kosova me nivelin e treguar në zgjedhjet e 6 tetorit, në një proces kaq demokratik, fer dhe të drejtë, ka dëshmuar që është partnere e Evropës, me të drejtë i takon kësaj familje të madhe dhe në këtë rrugëtim tonin kërkojmë mbështetjen e Norvegjisë. Theksova, po ashtu, rëndësinë e vazhdimit të dialogut me Serbinë pa kushte si proces i rëndësishëm për njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe stabilitet në rajon", ka shkruar Haradinaj.



Është prezantuar raporti me gjetjet nga monitorimi i gjyqësorit të Kosovës

EULEX-i: Shqyrtimi i rasteve të profilit të lartë, i ngadaltë



Drejtuesit e EULEX-it kanë bërë me dije se është me rëndësi që ky mision të vazhdojë të punojë krah për krah me institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit. Gjatë prezantimit të raportit të EULEX-it me gjetjet nga monitorimi i gjyqësorit të Kosovës, është thënë se shqyrtimi i rasteve të profilit të lartë nga gjyqësori i Kosovës mbetet i ngadaltë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 TETOR - Misioni i BE-së në Kosovë për sundim të ligjit, EULEX, ka prezantuar raportin e tretë me gjetjet nga monitorimi sistematik dhe tematik në gjyqësorin e Kosovës. Gjatë prezantimit të këtij raporti ushtruesi i detyrës së shefit të EULEX-it, Bernd Thran, ka thënë se monitorimi i thuktë i rasteve të përgjeshura ka dëshmuar të jetë një mjet efektiv për vlerësimin e përputhshmërisë së sistemit të drejtësisë vendëse me legjislacionin e Kosovës dhe standardet për të drejtat e njeriut. "Puna e këtij misioni në këtë fushë

është e trefishtë: së pari, ne i identifikojmë trendët dhe dukuritë që ndikojnë në funksionimin e gjyqësorit; së dyti, ne japin rekomandime të cilat janë të përfshira në raport dhe; së treti, aty ku është e mundur, hartojmë dhe zbatojmë projekte në bazë të zbrazëtirave të identifikuara për adresimin e këtyre gjetjeve. Një shembull për këtë është seminari i organizuar kohët e fundit për fuqizimin e kapaciteteve të prokurorëve specialë dhe zyrtarëve ligjorë për ndjekjen penale të rasteve të terrorizmit", ka thënë Thran. Ai ka deklaruar se është me rëndësi që EULEX-i të vazhdojë të punojë krah për krah me institucionet e Kosovës

për sundimin e ligjit ngaqë, sipas tij, këto institucione kanë synim të njëjtë: ta bëjnë sistemin e drejtësisë të qasshëm për secilin dhe të besueshëm për qytetarët.

Gjatë prezantimit të gjetjeve të këtij raporti, udhëheqësi i njësisë për monitorimin e rasteve, Hubert van Eck Koster, ka thënë se EULEX-i ka vërejtur një trend pozitiv nëpër seancat dëgjimore nëpër gjykata të cilat i ka monitoruar, me një rritje të dukshme të seancave dëgjimore produktive kundrejt atyre joproduktive. Duke komentuar rreth ritmit të shqyrtimit të rasteve të profilit të lartë të cilat më parë janë trajtuar nga EULEX-i, Van Eck Koster ka theksuar se ai "në

përgjithësi mbetet i ngadaltë". Ky raport, i cili është vazhdimësi e dy raporteve të ngjashme të publikuara më herët gjatë këtij viti nga ana e EULEX-it në kuadër të iniciativës "Drejtësia 2020", përfshinë rekomandime të përshtatura për trajtimin e çështjeve të identifikuara përmes monitorimit të thuktë nga EULEX-i.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skender Çoçaj, e ka vlerësuar pozitiv raportin. "Ky është një raport i mirë. Sipas gjetjeve që janë përfshirë aty, shihet se ka përparim", ka thënë ai, duke e theksuar rëndësinë e faktit se raporti, po ashtu, përfshinë rekomandime konkrete për mënyrën e trajtimit të sfidave që kanë mbetur. Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Arben Ismajli, e ka përshëndetur raportin, duke thënë se ai përfshinë një numër të rekomandimeve të drejtpërdrejta për avancimin e sistemit prokurorial të Kosovës. Kurse në fjalën përmbyllëse, u. d. i shefit të EULEX-it,

Bernd Thran, ka thënë se rekomandimet e këtij raporti do të jenë të dobishme për institucionet e Kosovës. "Shpresojmë se gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë raport do të jenë mjet i dobishëm në dispozicion të institucioneve të Kosovës për fuqizimin e sundimit të ligjit, për kryerjen e reformave dhe të jenë vazhdimësi e përpjekjeve të kaluara dhe aktuale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë", ka thënë Thran.

Njësia e EULEX-it për Monitorimin e Rasteve e bën vlerësimin e funksionimit të gjyqësorit të Kosovës në aspektin e përputhshmërive procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut. Vlerësimi kryhet përmes monitorimit të thuktë sistematik dhe tematik të rasteve të përgjeshura penale dhe civile, përfshirë rastet e profilit të lartë dhe rastet që më parë janë trajtuar nga EULEX-i. Ky mision e monitoron tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale, përkatësisht në nivelin e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit.

Një delegacion i Policisë së Maqedonisë Veriore vizitoi Kosovën

PRISHTINË, 9 TETOR - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, të mërkurën ka pritur në takim drejtorin e Sigurisë Publike të Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës si dhe shkëmbimi i informacioneve me interes të përbashkët për parandalim të kriminalitetit. Qalaj dhe Tasevski kanë diskutuar

angazhimet ku përfshihen: bashkëpunimi ndërkuftar, koordinimi i ndërsjellë dhe mbulimi i përbashkët i kufirit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës si dhe shkëmbimi i informacioneve me interes të përbashkët për parandalim të kriminalitetit. Qalaj dhe Tasevski kanë diskutuar

edhe për përgatitjet dhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta rreth planifikimit të masave për siguri në lidhje me sigurimin e ndeshjes së futbollit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020 si dhe për çështje të tjera me interes të përbashkët.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e radhës

KQZ-ja vendos për rinumërimin e 313 vendvotimeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim që 313 vendvotime të shkojnë në rinumërim. Rinumërimin e këtyre vendvotimeve në mbledhjen e KQZ-së e ka rekomanduar Qendra e Numërimit të Rezultateve. Sipas KQZ-së, 303 vendvotime do t'i nënshtrohen rinumërimit pasi që janë evidentuar gabime teknike në formularët në të cilët janë bartur votat, ndërsa në 10 vendvotime të tjera është vërejtur mungesë e votave të kandidatëve të disa fletëve të formularëve të rezultateve si dhe disa mungesa të nënshkrimeve

EPOKA
ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 9 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur të mërkurën për rinumërimin e 313 vendvotimeve bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Rinumërimin e këtyre vendvotimeve në mbledhjen e KQZ-së e ka rekomanduar Qendra e Numërimit të Rezultateve. Sipas KQZ-së, 303 vendvotime do t'i nënshtrohen rinumërimit pasi janë evidentuar gabime teknike në formularët në të cilët janë bartur votat, ndërsa në 10 vendvotime të tjera është vërejtur mungesë e votave të kandidatëve të rezultateve si dhe disa mungesa të nënshkrimeve.

Koordinatori i QNR-së, Burim Ahmetaj, në mbledhjen e KQZ-së

ka treguar për disa parregullsi që kanë hasur gjatë procesit të numërimit të votave. "Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve një numër i rezultateve nuk ka mundur të procedohet siç ishte ndërrimi i shiritave apo edhe mospërputhjet me faqe. Ne i kemi dërguar në karantinë dhe i kemi bashkangjitur raportet. Ky raport thotë se duhet patjetër të numërohet. Në disa vendvotime mungon përputhja me fletëvotime", është shprehur Ahmetaj.

Ndërsa kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se formularët janë shtypur gabimisht. Sipas saj, këtu ka të bëjë me gabime teknike e jo për manipulim. "S'po flitet për manipulim, por për një gabim teknik që ka ndodhur për shkak të shtypjes së gabueshme të formularëve. Duhet të deklarohet publikisht e të mos fshihemi. Formularët

janë shtypur gabimisht. I kujt është faji do të zbulohet gjatë ditëve të ardhshme. Sekretariati është bartës i shtypjes së tyre e që janë shpërndarë në të gjithë Kosovën. Janë shpërndarë të njëjtit formularë dhe të njëjtit e kanë pasur gabimin teknik që subjektet të cilat ishin të renditura në fletëvotime dhe në formular, por subjektit të parë i mungon rubrika. Për rrjedhojë të kësaj, disa komisionarëve të cilëve iu ka ndezur llamba i kanë shkruar me saktësi, por disa të tjerëve që s'iu ka ndezur llamba kanë vazhduar nga subjekti i dytë dhe kanë krijuar një huti. Përfundimisht, QNR-ja i ka zbuluar 303 vendvotime deri më tani, të cilat janë

plotësuar në këtë mënyrë. Si përfundim, këta formularë, qoftë sot, qoftë pas një muaji, s'mund të procedohen si të tillë sepse janë plotësuar në mënyrë të gabueshme. Kemi rekomandim për rinumërim të 303 vendvotimeve në tërësi", ka thënë Daka, duke sqaruar gabimet që kanë çuar në rekomandim për rinumërim.

Ndërsa përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje (LV) në KQZ, Adnan Rustemi ka kërkuar shtimin e anëtarëve në QNR. Nga katër vëzhgues sa janë në QNR, u kërkuar që ky numër të dyfishohet në tetë. "Në radhë të parë subjekteve u lejohen që t'i kenë më shumë se katër

vëzhgues. Kërkohet shtimi i vëzhguesve në QNR. Nga katër vëzhgues sa janë tani, të rritet ky numër në tetë. Kjo do të thotë jo detyrimisht, por varësisht nga dëshira e partive. Gjithashtu, të bëhet edhe një gjë që mos të fillojë rinumërimi i kutive pa pasur një vëzhgues të partive në tavolinë", është shprehur Rustemi. Kurse përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në KQZ, Ilir Gashi, ka thënë se është një kategori tjetër ku votat janë përmirësuar. Ai ka pyetur se si janë përmirësuar ato dhe me çfarë të drejte. Sipas Gashit, edhe për këto vendvotime duhet të vijë rekomandimi për rinumërim.

UNDP-ja i dhuron Policisë së Kosovës softuer për siguri kibernetike

PRISHTINË, 9 TETOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë i ka dhuruar Policisë së Kosovës softuerin për ndërmarrje SPLUNK që do ta përmirësojë mbrojtjen e të gjitha të dhënave të ndjeshme. Në emër të Policisë së Kosovës, drejtor i Departamentit për Shërbime Mbështetëse, Hamdi Hyseni, ka nënshkruar dokumentin e dorëzimit. Sipas UNDP-së, ky është edhe një hap tjetër i Programit të Sigurisë në Kosovë (KSSP) / Luftimi i Krimit Kibernetik në Kosovë (C3K) në mbështetje të vazhdueshme për Policinë e Kosovës dhe palët e tjera të interesit për ngritjen e teknologjisë dhe kapaciteteve njerëzore për parandalimin e sulmeve kibernetike me qëllim të rritjes së sigurisë kibernetike në përgjithësi. "Softueri i ndërmarrjes SPLUNK do t'i ofrojë



mundësinë Policisë së Kosovës t'i monitorojë të gjitha sistemet e informacionit në kohë reale dhe me qasje integruese. Kjo është thel-

bësore për mbrojtjen e të gjitha të dhënave të ndjeshme brenda Policisë së Kosovës. Softueri do t'i ngrëhtë aftësitë e zbulimit dhe t'i

bëjë më efikase veprimet e sigurisë përmes reagimeve më të shpejta që për këtë qëllim, do të sigurojnë të gjithë organet e zbatimit të ligjit dhe

sigurisë në Kosovë", është thënë në komunikatën për medie të UNDP-së.

Programi i Sigurisë i UNDP-së në Kosovë (KSSP) është plotësisht i integruar në institucionet përkatëse të sigurisë me një strategji mbështetëse për palët vendore të interesit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të sigurisë në zhvillimin teknologjik, zbatimin dhe harmonizimin e kornizës përkatëse ligjore, strategjive dhe planeve të veprimit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe direktivës së BE-së për sigurinë kibernetike me qëllim të rritjes së sigurisë publike për të gjithë qytetarët, me fokus të veçantë në sigurinë kibernetike.

Projekti Luftimi i Krimit Kibernetik në Kosovë (C3K) financohet nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme.

Banka Botërore: Ngadalësohet rritja ekonomike në Evropë



Sipas edicionit më të fundit të përditësimit ekonomik të Bankës Botërore (BB) për Evropë dhe Azi Qendrore (EAQ), rritja ekonomike në mbarë Evropën dhe Azinë Qendrore është duke u ngadalësuar me rritje rajonale të vlerësuar në 1.8 për qind për vitin 2019. "Rritja e ngadaltë në rajon shkon paralelisht me trendin global në rënie dhe nënvizon nevojën për ta përsheptuar produktivitetin dhe për t'i rritur investimet që kanë qenë në rënie gjatë dekadës së fundit", është thënë në raportin e Bankës Botërore

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

WASHINGTON, 9 TETOR - Rritja ekonomike në mbarë Evropën dhe Azinë Qendrore po ngadalësohet me rritje rajonale të vlerësuar në 1.8 për qind për vitin 2019, sipas edicionit të fundit të përditësimit ekonomik të Bankës Botërore (BB) për Evropën dhe Azinë Qendrore (EAQ).

Ky vlerësim, më i ulëti në katër vjetet e fundit, pasqyron rritjen e ngadalësuar si në federatën ruse, po ashtu edhe në Turqi, dy ekonomitë më të mëdha të rajonit.

Raporti, gjithashtu, ka vënë në pah rritjen e fuqishme në pjesët e tjera të rajonit, duke përfshirë vendet në Evropën Qendrore, Azinë Qendrore dhe Kaukazin e Jugut. "Rritja e ngadaltë në rajon

shkon paralelisht me trendin global në rënie dhe nënvizon nevojën për ta përsheptuar produktivitetin dhe për t'i rritur investimet që kanë qenë në rënie gjatë dekadës së fundit. Në EAQ, përqësimi i trendëve demografikë, duke përfshirë tkurrjen e popullsisë në moshë pune, acaron tutje sfidat e mësipërme. Raporti hedh vështrimin mbi trendët e migracionit dhe ofron njohuri domethënëse si për vendet e destinacionit ashtu edhe ato të origjinës", është thënë në raportin e BB-së.

Sipas këtij raporti, Asli Demirguc-Kunt, kryeekonomiste e Bankës Botërore për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, ka thënë se migracioni mund t'i kontribuojë prosperitetit në rajon.

"Emigrantët në mënyrë jopro-

porcionale kanë tendencë të jenë në moshë pune, prandaj mund t'i shtendosin presionet demografike duke rritur madhësinë e fuqisë punëtore, duke ngritur produktivitetin dhe duke i dhënë hov rritjes ekonomike", është thënë në raportin e BB-së, duke u shtuar se përpjesa e emigrantëve në Evropë është rritur me shpejtësi të madhe gjatë katër dekadave të fundit, ku një nga tre emigrantët në mbarë botën tani e ka si pikësynim Evropën. "Migrimi ndër-rajonal është, gjithashtu, i lartë në Evropë dhe Azi Qendrore, me 80 për qind të emigrantëve që zgjedhin të shpërngulen në vendet e tjera të rajonit. Mirëpo, shpeshherë kundërshtimi ndaj migracionit është i fuqishëm sepse tendenca është që përfitimet të jenë afatgjata ndërsa kostot, përfshirë zhvendosjen

dhe papunësinë, janë të menjëhershme dhe të përqendruara në mesin e grupeve të caktuara. Politikëbërësit duhet t'i ndihmojnë këto grupe duke hartuar programe për rikualifikimin e tyre dhe duke i përshtatur sistemet arsimore enkas për të rinjtë, në mënyrë që ata të mos konkurrojnë me emigrantët me kualifikime më të ulëta. Sipas raportit, komponentët e përpjekjeve të tilla do të mund të përfshinin përfitime kalimtare nga programet e mirëqenies dhe pagesa të skemave të sigurimeve të papunësisë", është thënë më tutje në raportin e Bankës Botërore (BB).

Gjithnjë duke iu referuar këtij raporti, emigracioni ngrë shqetësime rreth "ikjes së trurit" dhe të krahut të kualifikuar të punës nga vendet e origjinës, meqë individët më të arsimuar janë të prirë të emigrojnë më shpesh brenda rajonit. "Individët me arsim të lartë përfaqësojnë 55 për qind të popullsisë së përgjithshme të emigrantëve nga Bosnja dhe Hercegovina, më shumë se 40 për qind të emigrantëve nga Armenia dhe Letonia dhe afër 40 për qind të popullsisë emigrante nga Shqipëria, Moldavia,

Maqedonia e Veriut, Republika Kirgize, Kazakistani, Rumania dhe Tashkistani. Modelet e tilla të vazhdueshme janë më shpesh simptomë sesa shkak i problemit rrënjësor", është thënë në raportin e fjalë.

Raporti i BB-së ka theksuar se përmirësimi i qeverisjes dhe forcimi i institucioneve në vendet e origjinës janë politika afatgjata që mund t'i adresojnë shkaqet rrënjësore të emigracionit të vazhdueshëm. "Politikat që synojnë ruajtjen e krahut të kualifikuar të punës përfshijnë promovimin e sektorit privat dhe përsheptimin e krijimit të vendeve të punës, investimin në arsimin e lartë dhe rritjen e mundësive për gratë në ekonomi. Lidhshmëria më e madhe, gjithashtu, paraqet aspekt të rëndësishëm të rritjes së angazhimit me diasporën, meqë emigrantët që ruajnë lidhjet kanë më shumë të ngjarë të investojnë dhe të kthehen. Raporti tregon se shtimi i stimuljeve për të mbetur në vendin e origjinës ka më shumë të ngjarë ta frenojë migrimin jashtë vendit sesa ndjekja e politikave që kufizojnë përfitimet jashtë vendit", është thënë në fund të raportit të BB-së.

Diskutohet për rëndësinë e rishikimit dhe auditimit të pasqyrave financiare



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se raportimi dhe auditimi i pasqyrave financiare të ndërmarrjeve ndikon në performancën e kompanive dhe, si rrjedhojë, në uljen e informalitetit. "Është shumë e rëndësishme të diskutohet për auditimin dhe raportimin financiar pasi ka rëndësi jo vetëm për informim, por edhe për vetëdijesimin e kompanive në raportimin financiar", është shprehur Rukiqi

shumë mund ta kenë vetëm rishikimin e pasqyrave financiare. "Ndërmarrjet që kanë mbi katër milionë euro qarkullim duhet ta bëjnë auditimin. Rishikimi dhe auditimi janë çështje që rrisin besueshmërinë në pasqyrave financiare. Rishikimi mund të kryhet nga ndërmarrja, gjë që ndikon në

rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare. NVM-të janë komplekse në shumicën e rasteve pasi përdoruesit mund të thonë se një 'profesionist i ka rishikuar pasqyrat tona' dhe atë mund t'ua dërgojnë më pas bankave, porse auditimi ofron siguri maksimale", ka thënë Zeka.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 TETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve në Kosovë (ShKÇAK) dhe "Baker Tilly Kosovë", kanë organizuar të mërkurën konferencën me temë "Rishikimi i pasqyrave financiare, kërkesë ligjore për NVM në Kosovë". Me këtë rast, kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se raportimi dhe auditimi i pasqyrave financiare të ndërmarrjeve ndikon në performancën e kompanive dhe, si rrjedhojë, në uljen e informalitetit. "Është shumë e rëndësishme të diskutohet për auditimin dhe raportimin financiar pasi ka rëndësi jo vetëm për informim, por edhe për vetëdijesimin e kompanive në raportimin financiar. Çdo përmirësim i raportimit financiar ka ndikime pozitive në performancën e ekonomisë, në të njëjtën kohë në performancën e kompanisë", ka thënë Rukiqi, duke shtuar se çështja e informalitetit akoma mbetet sfidë. "Ne jemi duke folur çdoherë e më shumë për koston e kapitalit dhe normalisht se ka një lidhje të drejtpërdrejtë për rëndësinë e raportit

financiar. Çështja e ekonomisë informale është sfidë dhe ka ndikim substancial raporti financiar", ka thënë ai. Ndërsa drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë se në vazhdimësi kanë ofruar shërbime efikase për tatimpaguesit dhe se digjitalizimi i sistemit në këtë institucion mbetet prioritet. "ATK-ja në vazhdimësi parashtrohet kërkesë që të bëhet edhe raportimi financiar i bizneseve. Jemi në fazën e digjitalizimit të sistemit dhe na u ka paraqitur një masë jo e kënaqshme për kategorinë A që mos të jetë asnjë tatimpagues", ka thënë Murtezaj. Më tutje, ai ka folur edhe për marrëveshjen e vitit 2016 e cila është nënshkruar me KRPP-në e që, sipas tij, nuk ka zbatueshmëri të nivelit të kënaqshëm. "ATK-ja në vazhdimësi ka ofruar shërbime efikase konform tatimpaguesve dhe misionit tonë e që është: përmbushja tatimore, trajtimi i barabartë, si dhe lehtësira tatimore. Sa i përket përmbushjes tatimore ne kemi nënshkruar një marrëveshje me KRPP-në në vitin 2016 dhe nga ajo kohë s'është përmbushur kjo marrëveshje në nivelin e kënaqshëm. ATK-ja në

vazhdimësi parashtrohet kërkesë që të bëhet edhe raportimi financiar i bizneseve, pasi ne e kemi detyrë t'i raportojmë te KRRP-ja ato pasqyra, prandaj është e domosdoshme që ta rishikojmë këtë marrëveshje", ka thënë Murtezaj. Në anën tjetër, zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Sokol Havolli, ka thënë se informatat e sakta për raportim financiar ndikojnë në procesin e riskut, por edhe të mbikëqyrjes. "BQK-ja ka qenë e fokusuar vazhdimisht në agjendën e raportimit financiar. Informata e sakta për raportim financiar ndikojnë në procesin e riskut, por edhe të mbikëqyrjes. Është e rëndësishme të theksohet roli i procesit të auditimit dhe kontabilistëve pasi aplikimi i standardeve është i rëndësishëm vetëm nëse shtyhet nga kontabilistët dhe auditorët", është shprehur Havolli. Kurse Lulzim Zeka, partner auditues në "Baker Tilly Kosovë", ka thënë se është e rëndësishme të kategorizohen ndërmarrjet në ndërmarrje të vogla, të mesme dhe mëdha pasi, sipas tij, ato ndërmarrje që kanë mbi katër milionë euro janë të obliguara që të bëjnë auditimin, ndërsa ato që kanë qarkullin nën këtë

Murtezaj e Mazreku bisedojnë për zbatimin e Ligjit për tatimin e korporatave

PRISHTINË, 9 TETOR (ER) - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës (ShSK), Sami Mazreku. Qëllimi i këtij takimi ishte implementimi i Ligjit për tatimin e korporatave, i cili ka hyrë në fuqi në muajin gusht të këtij viti. "Në takim z. Mazreku u njoftua nga drejtori i ATK-së se sipas këtij ligji kompanitë e sigurimit, nga data 5 gusht 2019 e tutje, do të deklarohen dhe paguajnë tatim si çdo person tjetër juridik", është thënë në njoftimin e ATK-së.




Nxënësja nga Mitrovica me diplomë nderi nga Memoriali Lidice

MITROVICË, 9 TETOR (ER) - Elejsa Jashari, nxënëse në Shkollën Filllore "Eqrem Çabej" në Mitrovicë, është shpërblyer me diplomë nderi të Memorialit Lidice nga udhëheqësi i Ambasadës së Çekisë në Prishtinë, Pavel Bilek.

Punimi i vajzës 13-vjeçare, Elejsa Jashari, ishte i vetmi që është vlerësuar nga të gjitha punimet e dërguara nga Kosova, në ekspozitën ndërkombëtare të fëmijëve në arte të bukura "Lidice 2019". Me këtë rast, nxënësja Elejsa Jashari, së bashku me prindërit e saj dhe drejtoreshën e shkollës "Eqrem Çabej", Remzije Alidemaj, janë

pritur në zyrën e Ambasadës Çeke nga udhëheqësi i saj, për ta pranuar zyrtarisht mirënjohjen e nxënësës në fjalë.

Drejtoresha Alidemaj ka falënderuar udhëheqësin e Ambasadës së Çekisë për dorëzimin personal të diplomës. "Kjo u bë një ngjarje e rëndësishme për shkollën dhe ofroi një motivim për nxënësit dhe mësuesit, për të marrë pjesë edhe në vitin e ardhshëm. Shkolla 'Eqrem Çabej' është krenare për arritjet e nxënësve të saj dhe shpreson që emrat e tyre të vazhdojnë të lakohen nëpër lista të suksesit dhe lavdërimeve", ka thënë ajo.



Ngucati dhe Temeqina lidhen me rrugë të asfaltuara



MALISHEVË, 9 TETOR (ER) - Ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në fshatin Ngucat dhe një rrugë që lidhë këtë fshat me fshatin Temeqinë, me gjatësi prej 1 450 metrash, ku njëra prej këtyre

rrugëve ka rëndësi të veçantë, pasi ua lehtëson udhëtimin banorëve të lagjes së "Stolliqëve" dhe 60 nxënësve t'i vijojnë mësimet në shkollën e fshatit Temeqinë.

Asfaltimin e kësaj rruge dhe dy të

tjerave brenda fshatit Ngucat e ka parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Me këtë rast, ai ka thënë se janë të përkushtuar që t'i plotësojnë kërkesat e qytetarëve. "Kjo rrugë

dhe dy rrugë të tjera brenda fshatit Ngucat kanë rëndësi të madhe për banorët që jetojnë në këto lagje dhe ne si qeverisje komunale jemi të përkushtuar, që me aq sa kemi mundësi buxhetore, t'i plotëso-

jmë të gjitha kërkesat e banorëve, në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës", ka thënë Begaj.

Këto rrugë asfaltohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Kuçi: Rruga Junik - Gjeravicë, parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

JUNIK, 9 TETOR (ER) - Komuna e Junikut ka bërë me dije se është duke vazhduar asfaltimi i rrugës Junik - Gjeravicë, faza e II, e cila, sipas kësaj komune, është një rrugë strategjike me interes kombëtar për zhvillimin e turizmit dhe me ndikim në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për qytetarët e kësaj komune.

Kryetari i Junikut, Agron Kuçi, me stafin e vet ka përcjellë zhvil-

lim e punimeve nga afër dhe asfaltimin e rrugës Junik - Gjeravicë e ka cilësuar si parakusht për zhvillimin e hovshëm të turizmit, indikator në zhvillim ekonomik dhe krijim të kushteve për investime në bjeshkët e Junikut. Projekti i ndërtimit të rrugës Junik - Gjeravicë (segmenti fshati Gjocaj - Gropa e Erenikut) financohet nga Ministria e Infrastruktursë dhe Transportit.



PDK-së nuk i ndihmoi transformimi. Çka duhet tash?

Përtej transformimit të proklamuar në Kuvend dhe platformës elektorale antikorrupsion, nga PDK-ja kërkohet distancim me veprime konkrete nga segmentet e kriminalizuara



Shkruan: **Milazim KRASNIQI**

Humbja e PDK-së në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 ishte e pritshme. Humbja ishte e pritshme për dy arsye kryesore: e para, nga konsumimi i gjatë në pushtet dhe, e dyta, nga satanizimi që i është bërë në vazhdimësi, edhe në fushatë, nga të gjitha partitë rivale. Sa i përket qëndrimit të gjatë në pushtet (2007-2019) ai vërtet do ta konsumonte çdo parti, veçmas në një realitet

shoqëror, ekonomik dhe politik turbulent sikundër është Kosova, një shtet i papërfunduar, i varfër, i traumatizuar nga lufta, i izoluar nga bota dhe nën presione permanente jo vetëm të armiqve, po edhe të sponsorëve të vet. Por, përtej këtij sfondi të pavaforshëm për një qeverisje të suksesshme, qeverisja e PDK-së është karakterizuar edhe nga aspekte negative të brendshme siç janë korrupsioni, nepotizmi, kapardisja e pushtetarëve, shpërdorimi i fondeve publike, klientelizmi. Pjesa më morbide e këtyre aspekteve negative kanë qenë disa figura emblematike të saj, të ashtuquajturit njerëz të fortë, të cilët në shumë raste janë sjellë sikur janë mbi ligjin, që nga privatizimet, punësimet e deri te drejtësia. Figurat e tilla, duke e

pasur prestigjin nga lufta, e kanë keqpërdorur PDK-në si parti, duke e paraqitur në sytë e qytetarëve si abuzuese dhe dhunuese të interesave të tyre. E drejta, këto figura kanë qenë jo vetëm mbi ligjin, po edhe mbi PDK-në, sepse ajo nuk ka pasur fuqi ose vullnet që t'i mbajë nën kontroll. Por, në të dyja rastet, dëshpërimi i qytetarëve i është faturuar PDK-së. Dhe s'ka si të jetë ndryshe logjikisht, pasi partia duhet t'i imponojë statutin, programin dhe normat e sjelljes për të gjithë anëtarët, e jo t'i seleksionojë në modelin cinik orvelian. Në fakt, në emër të PDK-së ka sunduar një establishment, gjithsesi i përbërë nga disa figura të PDK-së, po edhe të disa figurave të tjera, të futur aty nga sfera e biznesit, e medias dhe e drejtësisë. Nëse mund të thuhet se shteti ka qenë i kapur, ai ka qenë i kapur prej atij establishmenti. Por, sërish fatura i ka shkuar në tavolinë PDK-së, për faktin se nuk ka pasur fuqi t'i

bëjë zap ata që kanë keqqueverisur në emër të saj. Ndërsa, rivalët politikë këtë gjendje e kanë shfrytëzuar për ta portretizuar PDK-në me ngjyrat më të errëta. Nga ana tjetër, koalicioni PAN ka qenë vendim katastrofal i PDK-së, sepse në qeverinë Haradinaj, PDK ka qenë më shumë patericë e kryeministrit se sa partia më e madhe e koalicionit qeverisës. Edhe në këtë rast dështimi i është faturuar si partia më e madhe e koalicionit qeverisës. Realisht, vetë fakti që e ka toleruar atë model qeverisjeje, i cili i ka përkeqësuar edhe raportet me aleatët strategjikë të Kosovës, e ka bërë PDK-në përgjegjëse. Në këso rrethanash, provokimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme nga vetë kryeministri, PDK-në u duk se e zuri të hutuar. Por, gjatë fushatës ka pasur një konsolidim të çuditshëm, gjë që dëshmon se ajo ka struktura dinamike, ka elektorat stabil dhe mundësi edhe më të

mëdha. Mirëpo, ajo që i duhet pas këtij rezultati, ku doli partia e tretë, është diçka më shumë se sa transformimi që ka realizuar në Kuvendin e saj të fundit: PDK-së i duhet distancim i plotë dhe i sigurt nga sjelljet brutale dhe joligjore të disa prej eksponentëve të saj kryesorë në arsim, në ekonomi dhe në drejtësi. Fjala vjen, ndikimin okult dhe joligjor në universitet publike, ku njerëz të identifikuar me PDK-në zgjedhin dekanë, rektorë e administratorë për qejfet e veta. Nëse nuk e çmonton vetë strukturën e tillë okulte, nuk do të jetë e besueshme platforma elektorale e Kadri Veselit për luftimin e korrupsionit dhe të nepotizmit. Pra, përtej transformimit të proklamuar në Kuvend dhe platformës elektorale antikorrupsion, nga PDK-ja kërkohet distancim me veprime konkrete nga segmentet e kriminalizuara. Evokimi i bëmave të tyre ia ka shkaktuar humbjen, më shumë sesa rivalët.

Replikë me një mik akademik: Ja pse na duhen zgjedhjet në Kosovë!



Prof. **Lisen BASHKURTI**

Një mik i kahershëm imi dhe akademik i nderuar, ndoshta nga dëshpërimi, këto ditë bëri një postim në profilin e vet me mesazhin... "Ç'na duhen zgjedhjet në Kosovë?" Me thënë të

drejtën e kuptova, por edhe u çudita. Si nuk na duhen zgjedhjet në Kosovë?! Na duhen, bile shumë, madje më shumë se kurrë, kur shohim se sa mirë bëhen zgjedhjet në Kosovë. Na duhen, madje edhe si model, kur vërejmë se si i zgjidhin krizat vëllezërit tanë përmes zgjedhjeve të parakohshme. Na duhen për të parë se si bëhen fushatat pa tallje e fyerje, por me etikë e dinjitet. Na duhen, fort bile, për të shikuar se si bëhen votimet ditën e zgjedhjeve, si një festë popullore. Na duhen që të na plasin

sytë kur mësojmë se si numërohen votat dhe tabulohet rezultati për tri orë. Na duhen edhe për të mësuar se si pritët fitorja me qetësi dhe humbja me dinjitet. Na duhen që ç'ke më të, që t'i vëmë gishtin kokës nga qeveritë, politika, media, deri te qytetarët e thjeshtë, që të kuptojmë një herë e mirë se institucionet demokratike kanë si parim bazë zgjedhjet legjitime. Na duhen, aq shumë, deri në turpërim, kur kthejmë kokën pas e shohim se çfarë masakra kemi bërë me zgjedhjet tona në

tridhjetë vjetët e tranzicionit pseudo-demokratik. Të skuqemi deri në veshë për talljen që kemi dëshmuar me institucionin e shenjtë të votës. Na duhen ore na duhen që ç'ke më të, për të mësuar, para së gjithash, nga vëllezërit tanë kosovarë, përpara se të mësojmë nga bota e qytetëruar. Na duhen për të parë e kuptuar se sa i dëmshëm dhe neveritshëm është autoritarizmi i korrup-tuar; patriotizmi i abuzuar; popullizmi vulgar; nepotizmi i kancerogjen; inkriminimi deri në palcë; diletantizmi në çdo

qelizë; oratoria prolipse dhe pa ide; idetë e zbrazura pa argumente e kulturë; premtimet e mbuluara nga gënjeshttrat propagandistike; propaganda e blerë dhe e shitur me mundin e njerëzve; njerëzit e rropatur e të nëpërkëmbur paturpësisht që ikin nga sytë këmbët, për të mos u kthyer më kurrë në tokën e tyre atërore... Si nuk na duhen zgjedhjet në Kosovë, o miku im, akademik i nderuar! Na duhen ore, na duhen shumë, na duhen fort, na duhen për sot, për nesër e për gjithmonë.

Vazhdojnë punimet për zgjerimin e Sheshit "Adem Jashari" në Skenderaj

SKENDERAJ, 9 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, inxhinierë dhe profesionistë, kanë inspektuar punimet që po bëhen në zgjerimin e Sheshit "Adem Jashari". Me këtë rast, Jashari ka theksuar se ky shesh do të bëhet modern. "Punimet në zgjerimin e Sheshit 'Adem

Jashari' po vazhdojnë sipas planit. Së shpejti ky shesh do të ketë pamje tjetër, do të bëhet më modern, më atraktiv falë investimeve që po bëjmë në qytetin tonë të Skenderajt. Së bashku me nënkryetarin Nuredin Lushtaku, inxhinierë dhe profesionistë, pamë nga afër punimet që po bëhen për zgjerimin e sheshit", ka thënë Jashari.



Parlamenti britanik zhvillon javën tjetër seancën vendimtare për Brexit

LONDËR, 9 TETOR - Deputetët britanikë janë thirrur që të jenë pjesë e një seance speciale të shtunën, meqë kjo ditë konsiderohet vendimtare për procesin e Brexitit, apo largimit të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. Parlamenti do të takohet më 19 tetor pas samitit të Bashkimit Evropian, në të cilin ekziston mundësia e fundit që Britania dhe blloku evropian të arrijnë një marrëveshje para 31 tetorit. Nëse arrihet ndonjë marrëveshje, kryeministri britanik, Boris Johnson do të kërkojë miratimin e deputetëve britanikë, mirëpo nëse

nuk ndodh një gjë e tillë, një varg skenarësh të tjera janë të disponueshme. Johnsoni ka thënë me bindje se Mbretëria e Bashkuar do të largohet nga Bashkimi Evropian më 31 tetor, pavarësisht legjislacionit i cili detyron atë t'i kërkojë BE-së një shtyrje tjetër të Brexit-it, nëse nuk arrihet marrëveshje deri më 19 tetor, apo përveç nëse deputetët arrijnë pajtueshmëri për Brexit pa marrëveshje. Parlamenti britanik është mbledhur vetëm në katër të shtuna nga viti 1939, duke përfshirë 2 shtatorin e atij viti, si pasojë e nisjes së Luftës

së Dytë Botërore. Negociatat në mes të Mbretërisë së Bashkuar dhe Britanisë janë duke vazhduar ende, derisa në qendër të tyre mbetet ndalesa në kufirin irlandez, politikë e diskutuar në mes të ish-kryeministres britanike, Theresa May dhe BE-së, me qëllim të parandalimit të një kufiri të ashpër në mes të Irlandës Veriore dhe Republikës së Irlandës. Një ditë më parë, burime të Qeverisë britanike kanë thënë se marrëveshja për Brexit, apo për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian, është në thelb e pamundur.



Turqia nis operacionin në Sirinë Veriore

Presidenti Rexhep Tajip Erdogan njoftoi fillimin e operacionit të planifikuar ushtarak në Sirinë Veriore dhe tha se ai kishte për qëllim zhdukjen e kërcënimit të terrorit kundër Turqisë

ANKARA, 9 TETOR - Turqia nisi një operacion ushtarak të planifikuar për një kohë të gjatë në verin e Sirisë për t'i nxjerrë forcat kurde të etiketuara nga Ankaraja si terroristë, por që shihen nga shumica e Perëndimit si partnerë kryesorë në luftën kundër Shtetit Islamik. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan njoftoi fillimin e operacionit, të quajtur "Pranvera e paqes" dhe tha se ai kishte për qëllim zhdukjen e kërcënimit të terrorit kundër Turqisë, ka njoftuar voa.

Forcat Demokratike Siriane të udhëhequra nga kurdët (FDS) thanë që avionët luftarakë turq po godasin zona civile, duke shkaktuar panik të madh. Operacioni ushtarak filloi disa ditë pas një njoftimi të befasishtëm të Shtëpisë së Bardhë se forcat amerikane do të tërhiqeshin nga rajoni, duke hapur rrugën operacionit ushtarak turk.

Presidenti Donald Trump po vazhdon të mbrojë vendimin e tij, mes kritikave të gjera në Uashington, duke thënë se luftërat e kota të pafundme për ne po mbarojnë! "Luftimet mes grupeve të



ndryshme kanë vazhduar për qindra vjet. ShBA-ja nuk duhet të kishte qenë kurrë në Lindjen e Mesme. Lëvizëm 50 ushtarët tanë! Turqia duhet të marrë përsipër luftëtarët e kapur të ISIS-it që Evropa nuk pranoi të ktheheshin. Luftërat e kota, për ne, për ne, po mbarojnë!", tha presidenti Trump të mërkurën, në një seri postimesh në Twitter për këtë çështje. Si ligjvënësit demokratë edhe ata republikanë kanë kritikuar ashpër tërheqjen amerikane nga Siria Veriore, duke thënë se Shtetet e Bashkuara po braktisnin kurdët sirianë që kishin luftuar grupin terrorist Shteti Islamik së bashku me trupat amerikane. "Nëse e dëgjoj presidentin të thotë edhe një

herë, "bëra një premtim fushate për të dalë nga Siria, do më turbullohet stomaku", tha senatori republikan Lindsay Graham. "Ai bëri një betim për të mbrojtur kombin kundër të gjithë armiqve, të huaj dhe vendas. Nuk ka asnjë armik më të madh për kombin tonë se ISIS. Dhe nuk ka asnjë mënyrë që ta mbrojmë vendin nga Islami radikal pa partnerë si kurdët", tha ai.

Përpara sulmit turk, Forcat Demokratike Siriane lëshoi thirrjen e vet për vendet e përfshira në koalicionin për të mposhtur ISIS-in dhe për të shmangur një katastrofë humanitare në veri të Sirisë. "Të gjithë treguesit, informacionet në terren dhe grumbul-

limet ushtarake në anën turke të kufirit tregojnë se zonat tona kufitare do të sulmohen nga Turqia, në bashkëpunim me opozitën siriane të lidhur me Turqinë", tha FDS. Ky sulm do të sjellë viktima në radhët e mijëra civilëve të pafajshëm sepse zonat tona kufitare janë të mbingarkuara.

Presidenti Trump ka këmbëngulur se nuk po braktis kurdët që luftuan me Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e koalicionit kundër ISIS-it. Në të njëjtën kohë, ai ka lavdëruar edhe Turqinë, duke e ftuar presidentin Erdogan të vizitojë Shtëpinë e Bardhë muajin tjetër (13 nëntor), ndërsa e quajti Ankaranë një "partner të madh

tregtar" dhe i atribuoi Qeverisë turke ndihmën për të shpëtuar shumë jetë njerëzish në provincën Idlib.

Zyrtarët ushtarakë amerikanë konfirmuan se kanë ripozicionuar rreth 50 anëtarë të forcës speciale amerikane, të cilët kishin vepruar përgjatë kufirit Turqi-Siri, për shkak të rreziqeve të sigurisë. "Fatkeqësisht, Turqia ka zgjedhur të veprojë në mënyrë të njëanshme", tha zëdhënësi i Pentagonit Jonathan Rath Hoffman në një deklaratë. "Si rezultat, ne kemi zhvendosur forcat amerikane në verin e Sirisë larg nga rruga e inkursionit të mundshëm turk për të ruajtur sigurinë e tyre", tha Hoffman.

Sandersi i kthehet fushatës për president


WASHINGTON, 9 TETOR - Kandidati demokrat për president Bernie Sanders thotë se së shpejti do t'i kthehet fushatës ndërsa po merr veten pas një goditje në zemër në shtëpinë e tij në Vermont. Duke folur me gazetaret pas një takimi me kardiologun të martën, Sandersi tha se ndihej mirë dhe se do të rishohë axhendën e takimeve në kuadër të fushatës. "Siç e dini, në disa

raste ne po kryenim pesë ose gjashtë takime në ditë, tri ose katër meetingje e takime me grupe të ndryshme njerëzish. Nuk besoj se do të vazhdoj ta bëj më këtë gjë. Por sigurisht kam ndërmend të bëj fushatë aktive. Mendoj se duhet ta ndryshojmë pak natyrën e fushatës", tha Sandersi.

Ai nuk dha ndonjë afat kohor se kur mund të kthehej në fushatë,

por tha se synon të bëjë diçka që lidhet me të përpara debatit të radhës mes kandidatëve demokratë që mbahet ditën e martë. Ai, gjithashtu, komentoi edhe zërat se gjendja e tij shëndetësore mund të përbëjë shqetësim për votuesit, duke u shprehur se votuesit e shohin në tërësi kandidatin, përfshirë integritetin dhe qëndrimin e tij për çështje të ndryshme.





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Safet Azemi shpall të pavlefshme diplomën e shkolle së mesme "Anton Çetta" Skenderaj
- ▶ Valon Bela shpalle te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e Kl. X, XI, XII SH.M.L. "Dardania" Hani Elezit.
- ▶ Selami Kryezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shf "Mic Sokoli" Lubeqev.
- ▶ Alba Hajdari shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren
- ▶ Shaqir Avdaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Fadil Hisari" Prizren.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pulë

cilësi e garantuar

pa konservues

E rrallë

Kur kafshët "fotografojnë" shpendët

Një ketër kurioz duket se ka prirje për fotograf tekta është fotografuar në një park në Londër, duke marrë rolin e një të filli. Objektivi i tij i preferuar janë pëllumbat, të cilët, siç edhe dallohet në fotogalerinë e mëposhtme, marrin poza si të jenë modelues profesionistë.




FOTO E DITES




Disa flamengo shihen duke u ushqyer jashtë një plazhi në veri të qytetit të Kuvajtit. /AFP/

E jashtëzakonshme

Kjo është makina më e shpejtë në botë

E keni pyetur ndonjëherë veten se "sa shpejt mund të ecin makinat"? Përgjigjja, natyrisht, varet nga lloji i makinës dhe cili është përkufizimi juaj për "makinën". Por cila konsiderohet si makina më e shpejtë në botë? Kjo "foshnjë", që shihni në foto, "Thrust SSC jet car", e vitit 1997, ka thyer të gjitha llojet e regjistrimeve përsëri në administratën e Klintonit. Bëri rreth 763 milje në orë në tetor të vitit 1997, sipas Librit Guinness të Rekordëve Botërore. Kjo është një shpejtësi që ende nuk është arritur. Ideja është që makina më e shpejtë në botë është më pak e



ngjashme me një makinë të zakonshme dhe, ndoshta, do të ishte më mirë të quhej një anije hapësinore me rrota.

BARSOLETA E DITËS



- A po punon?
- Po?
- Ku?
- Në një kompani të huaj këtu në Kosovë.
- Çfarë kompanie është?
- Është një dyqan kinez që shet çdo artikull nga një euro.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të kalojnë një ditë tërësisht ndryshe nga ditët e tjera.



DEMI

Sot mund të rikthehet në kujtesën tuaj, diçka që kishit vendosur ta harroni kohë më parë.



BINJAKËT

Binjakët mund të ndihen sot paksa të irrituar. Sot do të jeni shumë ndjeshëm.



GAFORRJA

Të lindurit e kësaj shenje do të ndihen më të fuqishëm se zakonisht. Kjo do t'ju motivojë për të kryer ca punë.



LUANI

Dikush mund t'ju përpiqet t'ju vërë në lojë në punë, gjë që mund t'ju mërzisë. Mos e humbi qetësinë se mund të shkaktoni probleme më të mëdha.



VI RGJËR ESHA

Ekziston mundësia të ndiheni të pavendosur lidhur me një çështje në punë.



PESHORJA

Për akrepat kjo ditë do të shkojë pa probleme.



AKREPI

Sot mund të injoroni diçka që ju shqetëson.



SHIGJETARI

Një ngjarje sot mund të nxjerrë në pah një anë tuajën, të cilës nuk i keni kushtuar shumë vëmendje.



BRICJAPI

Është dita e duhur për t'u kushtuar kohë personave me të cilët nuk jeni takuar prej kohësh.



UJORI

Mund të ndiheni konfuz gjatë kësaj të mërkure, ndaj këshillohet që të mendoni qetësisht rreth ndjenjave tuaja.



PESHQIT

Dita e somte do jetë fantastike. sidomos ajo në çift. Do jeni si të çmenduar nga gëzimi.

Kaq të ekspozuar nuk e kemi parë Katy Perryn



Katy Perry ka treguar gjoksin e vet me sutjene me ngjyrë të kaltër derisa ka treguar edhe linjën e vet të re të brendshmeve. Ajo është një yll i popit e njohur për zërin sensacional. Katy Perry (34) ka

treguar trupin seksi të hënën në mbrëmje. Krijuesja e hitit "Firework" ka treguar edhe një pjesë të krijimeve të veta, duke treguar se ajo edhe po argëtohet me linjën më të re dhe këtë e ka bërë në "Instagram".



Candice, një vajzë seksi

Candice Swanepoel ka pozuar me bikine derisa ka folur se si ajo ishte larguar nga Afrika e Jugut në moshën 16-vjeçare për të vazhduar modelimin. "Afrika është një pjesë në zemrën time", ka thënë ajo. Candice Swanepoel është një prej supermodeluesve më të paguara në votë e cila udhëton çdo vit në linjat Nju Jork-Paris-Milano. Por, shtëpia ku asaj i flenë zemra është për linjën "Tropic Of C" nga Afrika e Jugut.

Në një legjendë tepër prekëse, biondja bukuroshe ka biseduar edhe për kohën se kur ajo e la atdheun si një 16-vjeçare për ta vazhduar karrierën në modelim. E vendi i saj i mungon asaj shumë. "Një letër dashurie për Afrikën", ka filluar ajo. "E kam lënë Afrikën e Jugut kur isha 16-vjeçare për ta vazhduar karrierën time, por kurrë nuk e kam lënë. Ju nuk zgjidhni për të jetuar në Afrikë, por Afrika jeton në ju dhe me mua Afrika është çdo ditë".

Naomi Campbell ende nuk është gati për t'u bërë nënë



Ajo është një nga supermodelueset më të mëdha në botë dhe që i ka rezistuar tregut për shumë vjet. Naomi Campbell ka një karrierë të suksesshme, por për sa i përket jetës private ende nuk ka krijuar një familje. Pavarësisht se është 49 vjeçe, ylli i pasarelave shprehet se ende nuk është gati të bëhet nënë. Në një intervistë për "WSJ. Magazine", bukuroshja britanike është shprehur:

"Naomi të ketë fëmijë, ende jo, do të shoh se çfarë më sjell universi". Më tutje, ajo ka folur edhe për jetën e saj si beqare. "Të jesh vetëm nuk do të thotë të jesh i vetmuar. Nuk kam kohë të mërzitem dhe nuk kam kohë të ndihem e vetmuar", ka thënë Campbelli. Naomi ka thënë se privatësia për të është shumë e rëndësishme për sa i përket jetës personale dhe lidhjeve.

Miley Cyrus shtrohet në spital



Miley Cyrus është shtruar në spital. Këngëtarja dhe aktorja e famshme është duke luftuar me një sëmundje të paspecifikuar. Në një postim në mediet sociale 26-vjeçarja ka ftuar fansat të luten për të që të kishte një shëndet të plotë para ngjarjes së bamiresisë "Gorillapalooza" që

do të mbahet në fundjavë. "Gorillapalooza" është një ngjarje bamirësie. Fondet e mbledhura do të shkojnë për fondin "Ellen" për speciet e rrezikuara. Shtrimi në spital i Cyrusit vjen pasi njoftoi ndarjen nga bashkëshorti Liam Hemsworth dhe nga e dashura Kaitlynn Carter.

Bob Dylan: Vdekja, e vërteta e vetme

Nëse mendoni se do lexoni ndonjë opinion në lidhje me ndonjë dhënie çmimi, atëherë gaboheni rëndë. Të vetmen gjë që do gjeni këtu, është Vdekja.

"Not dark yet" apo, "Nuk është errësuar ende", është njëra nga shumë poezitë (këngët) e Bob Dylan-it. Më shumë se një poezi ajo paraqet krejt përpjekjet e kota të njeriut për ti dhënë kuptim jetës përballë vdekjes. A do ishim kaq fallc nëse do ishim të përjetshëm?

Qysh në fillim të poezisë, Bob Dylan godet:

"Errësira nuk ka rënë ende, por është në rrugë e sipër"

Vdekja nuk ka trokitur ende por është në rrugë e sipër. Në fakt, vdekja gjithmonë është në rrugë e sipër, ajo vazhdimisht është duke ardhur por asnjëherë nuk vjen. Ose së paku, ne nuk e kuptojmë edhe kur vie (nëse vie). Injoranca jonë mbi vdekjen, na vë përballë dy ndjesive: tmerrit (nga hici) dhe shpresës (për përjetësi). Më tmerrues ende, është fakti që për këtë shpresë, të gjithë e dimë se është e "pa shpresë", por prapë vazhdojmë. Njeriu e gënjen veten duke u gënjer. Ai e di këtë gënjeshtër të dyfishtë por nuk mund të largohet nga loja. Loja paraqet mundësinë e tij për të harruar vdekjen. Të gjitha përpjekjet e njeriut janë drejt lumturisë, por papritur shfaqet vdekja-kjo zonjë e paftuar. Rjedhimisht të gjitha përpjekjet kthehen në përpjekje për të gënjer veten në përballjen me fundin.

Për të qenë më korrekt me gjuhën, njeriun nuk e mundon vdekja, por "idea e vdekjes" Idea e vdekjes na tmerron sepse na kujton sa pak kohë kemi. Idea e vdekjes na bën të mendojmë se kurrë nuk do ti arrijmë të gjitha. Pse, a mund të arrihen të gjitha? "Not dark yet", është poezi "pesimiste" dhe e "errët" por e sinqertë në thelb. Nga këndvështrimi ekzistencialist, kjo poezi mund të ishte, "poezi e absurdit". Në paraqitjen e këtij absurdi apo pa-kuptimësie të jetës në raport me vdekjen, Dylan është shumë i pamëshirshëm dhe i ashpër. Në vazhdim ai shkruan:

"Humanizmi më ka humbur thaujse, Pas së bukurës gjithmonë fshihet dhembja"

Humbja e humanizmit ndodh pas ballafaqimit të njeriut me botën. Ndonëse jeta mund të duket e bukur, në esencë është një dhembje e pafundme, është një skëterrë. Sipas Schopenhauer, bota apo jeta, është e zymtë dhe e errët sepse udhëhiqet nga vullneti

i cili është i verbër dhe i cili nuk ka qëllime madhore. I vetmi qëllim i vullnetit është që "të jetë". Lumturia sipas Schopenhauerit mund të arrihet duke e shuar vullnetin dhe shmangur vuajtjet. Por përderisa jemi, vuajtja është domosdoshmëri.

"Kam rrahur të gjithë lumenjtë dhe të gjithë detërat. Preka edhe fundin e botës të mbushur me gënjeshtër. Madje nuk pashë asgjë as në sytë e njeriut."

Barra tanimë është bërë e papërbalueshme, Errësira nuk ka rënë ende por është në rrugë e sipër."

Çdo varg i poezisë sa shkon e bëhet më i errët. Në vazhdim Dylan thotë: ndonëse dallgët e jetës më kanë përplasur në shkëmbinjtë më të thepisur, ndonëse kam shkuar deri në fund të botës për të gjetur kuptimin dhe humanizmin, në fund, prapë se prapë kam hasur vetëm gënjeshtër dhe intriga. Kam takuar ziliqarë e grabitqarë. Bota është e ligë dhe e zezë.

Pasi humba shpresën në botën, e kërkova të vërtetën në sytë e njeriut. Ajo që pashë ishte edhe më e pamëshirshme, goditja e saj ishte përfundimtare, ishte goditja ndaj vetes. Sytë e njeriut janë bosh-pa kuptim. Ato nuk më thonë asgjë, prandaj nuk më mbetet tjetër vetëm të pres vdekjen, duke shpresuar që të vonojë sa më shumë.

Në fund të poezisë vie kulmi. Pas reflektimit mbi botën dhe pas vetëdijesimit se bota është e verbër dhe e shurdhërt, pasi e kuptojmë se bota nuk na flet, se ajo është vetëm një shkëmb i ftohtë, pasi kuptojmë që nuk mund të gjejmë përgjigje as tek tjetri, më në fund i kthehem vetes. Kthimi drejt vetes është pamundësia jonë për të kuptuar botën. Në botën jashtë nesh, nuk bëjnë pjesë vetëm objektet pa vetëdije, por edhe njeriu. Quhet njeri vetem sepse ka vetëdije përkundër gurit. Quhet njeri sepse kështu ka vendosur ta quaj veten. Kur i kthehem vetes mund të reflektoj. Ky reflektim fillon me një konstatim që të kall datën:

"Une kam lindur dhe do vdes pa dëshirën time"

Kjo paraqet një nga të vërtetat më të dhimbshme të njeriut. Nga kjo e vërtetë fillon jo-liria. E si mund të jem i lirë, kur nuk jam pyetur nëse dua të vi në jetë? Askush nuk



më ka pyetur nëse dua të jem pjesë e një bote plotë me sëmundje, plot me frikëra dhe pasiguri. Frika nuk vjen nga jashtë, por nga brendia ime. Frika ime jam unë, frika është mosnjohja e vetes.

Si mund të jem i lirë kur askush nuk më ka pyetur nëse dua ta pasuroj botën me dhimbje. Lindja ime ka ardhur përmes vuajtjeve. Të ekzistuarit tim do të shkaktojë vuajtje. Prania ime prodhon vuajtje. Dikush do pikëllohet edhe për largimin tim. Ai largim paraqet ligësinë time ndaj tjetrit, ligësi e cila është vetëm pjesë e ligësisë së madhe, asaj të ekzistencës së jetës. Kam nevojë të vegjetoj.

Përveç që nuk më kanë pyetur nëse dua të vi në jetë, askush nuk më pyet nëse dua të vdes. Askush nuk më pyet nëse kam frikë nga terri i nëntokës; askush nuk pyet nëse kam frikë nga mungesa e ajrit; askush nuk pyet nëse kam frikë nga krimbat; prandaj jeta është vuajtje dhe bota një skëterrë.

"Më bëhet sikur po lëviz por prapë qëndroj në vendnumëro"

Ka raste kur angazhohem, kur përpëlitem, kur më duket sikur kam arritur ca synime. Por vetëm po gënjej veten. A mund ti japim kuptim një gjëje e cila është e destinuar të shuhet? Rrugëtimit tashmë po i vie fundi. Po largohem nga ajo që quhet "jetë". Pyetja ende vlen: A kishte kuptim gjithë kjo? Përgjigja nuk vonon dhe është e ftohtë si mermeri dhe e heshtur si varri:

"Nuk mbaj mend asgjë, unë erdha vetëm për tu larguar nga këtu"

Këtu është kulmi i dhimbjes. Bota nuk ka qëllim; jeta nuk ka qëllim; absurdi paraqet njohjen e pakuptimshmërisë së botës; kur kuptimi i vetëm i gjithë ekzistencës është vetëm të vetëdijuar-

it mbi ekzistencën si diçka e ligë, ky është fundi i mundësive të mia. Vdekja paraqet kufirin tim.

"Nuk dëgjohen madje as pëshpërimat e lutësit, Errësira nuk ka rënë ende, por është në rrugë e sipër"

Kryevepra e kësaj poezie qëndron në vargun e parafundit. Në përballjen përfundimtare, aty në shtratin e vdekjes, nuk bën punë më as Zoti. Ai paraqet vetëm një qiell të zymtë me ca re kaotike. Ironia e Dylan-it është therrëse. Ai thotë se në fund të gjithë do jemi vetëm me veten. Do jemi përballë jetës tonë; do përrjetojmë momentet më intime që mund ti ketë njeriu: të jetoj vdekjen e tij. Vdekja është momenti më personal dhe i vetmi moment sinqeriteti i kristaltë me veten. Vetëm përballë vdekjes ne bëhemi të sinqertë. Kemi frikë nga të tjerët. Nga sytë e tyre. Vetëm përballë vdekjes ambiciet mjegullohen dhe të gjithë do përfundojmë si Ivan Ilichë. (L.Tolsoti-Vdekja e Ivan Ilichit)

Epilog: Vdekja, e vërteta e vetme

Çfarë kuptimi ka jeta, kur e dimë që do vdesim? Çfarë kuptimi kanë përpjekjet tona kur në fund do mbesim vetëm në varr? Çfarë kuptimi kanë gjithë arsyetimet ndaj të tjerëve, kur në fund do ti arsyetohemi vetem vetes dhe terit? Dikush edhe mund të thotë: "Së paku do hysh ne histori".

Me të vertete? Po a nuk e di që edhe historia do vdes? A nuk e di se gjithçka do kthehet në pluhur? Çdo vetëdije njerëzore do mbetet vetëm një grusht pluhuri? Historia është vetëm mjet për të arsyetuar ekzistencën dhe për të luftuar absurdin e jetës. A ka kasha histori? Po. Vetëm historinë tonë për të. Edhe ne një ditë do të përfundojmë histori për dikë tjetër.

Atëherë cili është qellimi jonë këtu? Ne jemi këtu vetëm si kalimtarë, si produkt i egos. Kjo

është kuptimi i pakuptimtë i ekzistencës. Këtë e thotë edhe Dylan. E kush do ja lexoj Bob Dylan-it tekstet pas 1 milion vjetësh? Me falni, a keni menduar ndonjëherë si do jetë bota pas 1 milion vjetësh? Dyshoj. Nëse vetëm pak do mendonit, do bëhej edhe pyetja tjetër, po pas 1 miliardë vjetësh??? Më mirë të mos mendoj, kushedi se ku do shkoj me pyetje.

Mungesa e pyetjeve është largim nga përballja me të vërtetat. Mungesa e pyetjeve paraqet frikën e njeriut nga vetja. Mallkuar qoftë dita kur lindi pyetja; mallkuar qoftë Filozofia, ky makth i pafundëm... Më mirë të jem kafshë, pa pyetje, pa ankth, pa ekzistencë.

Por kot e keni, sepse ju tashmë keni lindur, apo më mirë, Ju kanë lindur (pa ju pyetur). Dhe ju të gjithë do vdisni. Sado që mendojeni të mos pajtoheni me ato që thashë, prape ju siguroj që do vdisni. Do vuani, do klithni, do tmerroheni, do përpëliteni, dhe në fund prapë nuk i ikni vdekjes. I cmendur?? Ndoshta edhe jam! Por një gjë ju siguroj, edhe cmenduria ime do harrohet një ditë (nëse do ekzistojnë ditët). Të gjithë të cmendurit që kane jetuar ndonjëherë do shuhen. Më falni, a njihni ndonjë të cmendur që ka jetuar para 1000 vjetësh? Po para 2000 vjetësh?? Kështu edhe une do ngjas pas 1000 vjetësh. Nuk më plas fare se si do kujtohem. Madje ekziston edhe një mundësi tjetër: koncepti i cmendurisë pas 2000 vjetësh mund të ndryshojë. Ndoshta nuk do jetë më "cmenduri" por "mençuri" ahahahahah vërtetë mendoni se çaj kokën se si do jetë koncepti i cmendurisë pas 2000 vjetësh?

Për fund po ju lus vetëm një gjë: nëse po gënjej, ju lutem ma tregoni mua dhe Botës të vërtetën! Por nëse nuk mundeni dhe nëse nuk dini ndonjë të vërtetë tjetër përveç vdekjes, ju lus të heshtni përgjithmonë. (Ardian Batusha /KultPlus)

Funksionon vërtet – Kura tradicionale me gjethe dafine për shëndetin e pankreasit

Gjethet e dafinës janë fantastike në vlerat çudibërëse që ofrojnë për shëndetin e mirë të të gjithë organizmit.

Që nga lashtësia e deri në ditët e sotme kurat shëruese me përbërës kryesor gjethet e dafinës janë ndër më populloret në gjithë botën.

AgroWeb.org ju sjell më poshtë një kurë fantastike të përdorimit të gjetheve të dafinës për shëndetin e mirë të pankreasit.

Pankreasi është një organ i vogël që rrallë herë të vjen ndër mend. Pankreasi ka dy funksione bazë. Ky organ prodhon insulinën për të kontrolluar nivelet e sheqerit në gjak dhe enzimat për tretjen e yndyrave dhe proteinës.

Lëngu që prodhon pankreasi neutralizon acidet që lëshon stomaku, duke krijuar ambientin perfekt për enzimat tretëse.

Nëse pankreasi del jashtë funksioni, organizmi nuk përthith dot substancat e mira nga ushqimi.

Më poshtë do të gjeni hapat e thjeshtë se si të përgatitni kurën

me dafina për të lehtësuar dhimbjet e pankreasit dhe për të promovuar shëndetin e mirë të tij.

Kura me dafina

Për përgatitjen e kësaj kure ju duhen 3-4 lugë gjelle gjethe dafine të grimcuar dhe tre lugë gjelle me lëkura portokalli të grimcuara.

Gjethet dhe lëkurat mund t'i përdorni të thata por edhe të freskëta.

Zjeni më parë në një enë 3 filxhanë çaji me ujë, sapo të valojë hiqeni nga zjarri.

Më pas shtoni gjethet e grimcuara të dafinës dhe lëkurave të portokalleve në ujin e valuar, vendosini një kapak apo pjatë sipër dhe lëreni të pushojë për 15 minuta derisa gjethet e dafinës dhe lëkurat e portokallit të lëshojnë përbërësit e tyre.



Më pas, lëngu që përftohet kullohet, sipas dëshirës ëmbëlsohet me pak mjaltë ose jo.

Kjo përzjerje konsumohet dy herë në ditë në mëngjes dhe në mbrëmje dhe përmirëson procesin e tretjes së ushqimit në pankreas.

Dafina dhe sistemi tretës

Gjethet e dafinës kanë një impakt të fortë në sistemin tretës si

diuretik që ul nivelin e toksinave në trup dhe reagon ndaj helmimeve ushqimore.

Përmbytjet organike të gjetheve gjithashtu ndihmojnë me tretjen dhe qetësojnë një stomak të trazuar dhe zorrët.

Dafina dhe frymëmarrja

Vaji i dafinës mund të përdoret për të lyer kraharonin dhe ndihmuar me problemet me frymë-

marren.

Nëse nuk keni mundësi të përdorni vaj, mjafton të zieni ujë me dafinë dhe të shfrytëzoni avullin që do t'ju lehtësojë dhe do të eliminojë bakteret e rrezikshme që gjenden në sistemin e frymëmarrjes.

Por kujdes se përdorimi i vajit të dafinës i ndalohej grave shtatzëna.

Dafina ndihmon zemrën

Gjethet e dafinës kanë në përbajtjen e tyre acid kafeik dhe rutin, dy elementë që i japin zemrës forcë. Rutina forcon kapilarët e gjakut në zemër, ndërkohë që acidi largon kolesterolin e keq nga sistemi kardiovaskular.

Dafina kundër diabetit

Gjethet e dafinës kanë lidhje direkte me rregullimin e nivelit të sheqerit në gjak. Konsumimi i rregullt i gjetheve ul rrezikun e sëmundjes së diabetit./ AgroWeb.org

Hudhrrat e kuqe të shqipërisë – Pse çmohen fort për vlerat shëndetësore dhe Shijen

Ka disa produkte tipike shqiptare që ndoshta nuk përbëjnë shumë kuriozitet për vetë ne shqiptarët por kur vjen puna tek turistët e huaj, ato tërheqin menjëherë vëmendjen.

Një grup turistësh gjermanë, teksa vizituan rajonin e Prespës u mahnitën nga gatimet tradicionale shqiptare atje, teksa shijen më të veçantë të disa prej gatimeve tipike e kanë gjetur tek hudhrrat e kuqe.

Madje, ata janë kujdesur që disa tufëza të vogla me hudhra të kuqe t'i marrin me vete si produkte bio dhe të veçanta nga Shqipëria.

Ladi Çomo, administruesi i një pike agroturizmi thotë për AgroWeb.org se hudhrrat e kuqe

janë një produkt që tërheq shumë vëmendjen e turistëve të huaj.

"Duke qenë se është një produkt i veçantë dhe shijen e ka më unike se hudhrrat e bardha ne mendohejmë që t'ua prezantojmë vetë turistëve, të cilët jo vetëm mbeten të mahnitur kur e provojnë por marrin gjithnjë me vete.

E veçanta e kësaj hudhre është shija e fortë që ka duke i bërë speciale gatime.

Ndërkohë që hudhra e kuqe vlerësohet shumë edhe për vlerat e forta shëndetësore që ka. Këtu në zonën tonë ajo përdoret gjerësisht në kura të ndryshme popullore" thotë Çomo për AgroWeb.org.



E njohur në shqipëri, e rrallë në botë

Hudhra e kuqe është një varietet i veçantë, që fatmirësisht gjendet në zona të ndryshme të Shqipërisë por në botë ajo mbetet e rrallë.

Dikur, fara e saj ka qenë shumë popullore sidomos në fshatrat e vendit, zona në të cilat fshatarët kujdesen që ta kultivojnë edhe sot. Një varietet i rrallë, shumë i njohur nga shefat më prestigjioze të kuzhinës në botë ashtu si edhe nga mjekësia popullore për përdorimet e saj shëruese.

Ndonëse nuk haset shpesh në tregjet e mëdha, hudhrrat e kuqe gjenden lehtë në tregjet e fshatarëve dhe kanë të njëjtin çmim si ato të bardha.

AgroWeb.org ju sjell më poshtë vlerat e veçanta të hudhrës së kuqe, të cilat çmohen fort për vetitë e tyre shëndetësore.

Përfitimet shëndetësore të hudhrës së kuqe

Quket e kuqe për shkak të ngjyrës së lëkurës së saj ndonëse thelpinjtë e saj janë të bardhë.

Për nga pikëpamja e vlerave ushqimore, hudhra e kuqe ka të njëjtat vlera ashtu si edhe e bardha por në krahasim me këtë të fundit ka disa veti të tjera më të veçanta shëndetësore.

Hudhra e kuqe vlerësohet për përbajtjen e saj natyrale të organosulfurit, një substancë me shumë përfitime për shëndetin e

organizmit.

Këto substance vlerësohen se mbrojnë organizmin nga sëmundjet tumoriale.

Hudhra e kuqe vlerësohet gjithashtu për vetitë e forta anti inflamatore duke luftuar shumë sëmundje kronike, tumore, obezitetin, sëmundjet e zemrës ashtu si edhe diabetin.

Gjithashtu, ajo ka fuqi kundër infeksioneve, virozave dhe bakterëve duke vepruar si një antibiotik i vërtet natyral në organizëm.

Hudhra e kuqe është një burim i mirë vitaminash dhe mineralesh ndërsa vlerësohet për vetitë e saj antioksidante.

Shije e fortë, gatime speciale

Hudhra e kuqe veçon për shijen e saj të fortë, të thellë dhe pak pikante.

Ajo përdoret në receta të shefave prestigjioze të kuzhinës në përgatitjen e salcave të ndryshme.

E përdorur në receta të ndryshme ajo u jep gatimeve një shije të këndshme dhe aromë fantastike.

Ndaj dhe në pika të ndryshme agroturizmi në vend, hudhra e kuqe është shndërruar në një përbërës unik që me sa duket po tërheq shijen e turistëve të huaj.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandes: Dua maksimumin kundër Gjibraltarit

Përzgjedhësi Bernard Challandes ka kërkuar nga futbollistët "dardanë" të angazhohen maksimalisht në miqësoren ndaj Gjibraltarit pasi kjo lojë është një test i mirë për ndeshjen kualifikuese që Kosova e zhvillon më 14 tetor ndaj Malit të Zi. "Ndeshja ndaj Gjibraltarit nuk është vetëm një miqësore e thjeshtë, por do të jetë një ndeshje për t'u përgatitur ndaj Malit të Zi. Çdo lojtar duhet ta japë maksimumin në këtë miqësore pavarësisht a luan vetëm në pjesën e parë apo pak minuta", ka thënë trajneri zviceran



je. Kjo është pika kryesore. Nuk mendoj se do të jetë një ndeshje e lehtë, duhet të luajmë si kundër Anglisë", ka shtuar Rashkaj. Test të rëndësishëm për miqësoren ndaj Gjibraltarit e ka vlerësuar edhe kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani. Portieri i Torinos ka thënë se në këtë ndeshje mundësi e mirë do të jetë që të provohen edhe lojtarët që në ndeshjet paraprake nuk kanë pasur shumë hapësira. "Po përgatitemi për ndeshjen me Malin e Zi, që është si një finale për ne. Por, fillimisht të enjten e kemi Gjibraltarin, që është një test i mirë para kësaj ndeshjeje të madhe. Jemi optimistë për të vazhduar me ritmin e duhur. Ka ardhur koha të provohen edhe lojtarët që nuk kanë luajtur shumë, pasi kemi mjaftueshëm lojtarë në ekip dhe të gjithë duan të tregojnë se janë të gatshëm. Për ne çdo ndeshje është si finale dhe nuk duhet ta shikojmë shumë tabelën. Duhet të provojmë të fitojmë dhe të grumbullojmë sa më shumë pikë deri në fund", ka deklaruar Ujkani.

Për miqësoren ndaj Gjibraltarit në konferencë për medie foli edhe mesfushori Angel Rashkaj. Ai e ka vlerësuar të rëndësishme këtë përballje, sidomos për lojtarët që nuk kanë pasur shumë minuta në skuadrat e tyre. "E dimë që s'do të jetë e lehtë. Është skuadër e mirë dhe ka lojtarë që luajnë në ligat më të forta evropiane. Për ne çdo ndeshje është e rëndësishme, sepse kemi lojtarë që nuk kanë luajtur me skuadrat e tyre, por që do të kenë mundësi të luajnë ndaj Gjibraltarit. Duhet të jemi të fokusuar për çdo situatë", ka thënë Rashkaj, i cili është deklaruar edhe për ndeshjen kualifikuese për Kampionatin Evropian "Euro 2020" që Kosova e zhvillon katër ditë më vonë ndaj Malit të Zi. "Duhet të jemi të kujdesshëm dhe ta luajmë lojën tonë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm në çdo ndesh-

je. Kjo është pika kryesore. Nuk mendoj se do të jetë një ndeshje e lehtë, duhet të luajmë si kundër Anglisë", ka shtuar Rashkaj. Test të rëndësishëm për miqësoren ndaj Gjibraltarit e ka vlerësuar edhe kapiteni i Kosovës, Samir Ujkani. Portieri i Torinos ka thënë se në këtë ndeshje mundësi e mirë do të jetë që të provohen edhe lojtarët që në ndeshjet paraprake nuk kanë pasur shumë hapësira. "Po përgatitemi për ndeshjen me Malin e Zi, që është si një finale për ne. Por, fillimisht të enjten e kemi Gjibraltarin, që është një test i mirë para kësaj ndeshjeje të madhe. Jemi optimistë për të vazhduar me ritmin e duhur. Ka ardhur koha të provohen edhe lojtarët që nuk kanë luajtur shumë, pasi kemi mjaftueshëm lojtarë në ekip dhe të gjithë duan të tregojnë se janë të gatshëm. Për ne çdo ndeshje është si finale dhe nuk duhet ta shikojmë shumë tabelën. Duhet të provojmë të fitojmë dhe të grumbullojmë sa më shumë pikë deri në fund", ka deklaruar Ujkani.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për ndeshjen miqësore ndaj Gjibraltarit e cila zhvillohet sonte (e enjte) nga ora 18:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Trajneri Bernard Challandes në konferencën e fundit para kësaj miqësore u ka dërguar një porosi të gjithë lojtarëve se, pavarësisht a paraqiten në fillim apo në pjesën e

dytë, duhet ta japin maksimumin, pasi kjo është ndeshje shumë e rëndësishme për "dardanët". "Ndeshja ndaj Gjibraltarit nuk është vetëm një miqësore e thjeshtë, por një ndeshje për t'u përgatitur ndaj Malit të Zi. Çdo lojtar duhet ta japë maksimumin në këtë miqësore pavarësisht a luan vetëm në pjesën e parë apo pak minuta. Nëse një lojtar nuk e jep maksimumin, atëherë do të ketë probleme me mua, sepse kjo ndeshje është shumë e rëndësishme", ka thënë Challandes.

Crvena Zvezda nuk lejohet të hyjë në Kosovë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 TETOR - Skuadra serbe Crvena Zvezda të mërkurën ia ka mësyre Kosovës për ta zhvilluar ndeshjen e Kupës së Serbisë ndaj Trepçës serbe, por nuk është lejuar nga Policia e Kosovës, nga njësitë ROSU. Në kufirin e Jarinjës kishin mbërritur edhe tifozët serbë të Zvezdës, por as ata nuk janë lejuar të futen në territorin e Kosovës.

Federata e Futbollit e Kosovës ditën e martë kishte paralajmëruar se skuadra serbe nuk do të lejohet të hyjë në Kosovë, por ky paralajmërim nuk e ka penguar të

provojë ta bëjë një gjë të tillë. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se gjithmonë si federatë janë pro zhvillimit të ndeshjeve bamirëse dhe atyre miqësore, por do të jenë gjithmonë kundër zhvillimit të ndeshjeve të tilla në territorin e Kosovës. Ai ka thënë se zhvillimi i ndeshjeve të tilla në territorin e Kosovës është kundër statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës dhe atij të UEFA-s. "Ne e kemi kundërshtuar qysh në fillim dhe kemi kërkuar nga autoritetet përgjegjëse në Kosovë ta përkrahin vendimin tonë për të mos e lejuar Crvena Zvezdën të hyjë në Kosovë. Kemi qenë gjithmonë për promovimin e sportit



dhe kemi lejuar organizimin e ndeshjeve bamirëse dhe atyre miqësore, mirëpo asnjëherë nuk do ta lejojmë zhvillimin e ndeshjeve zyrtare të Serbisë në Kosovë sepse është kundër statutit tonë

dhe të UEFA-s. Për ne është e rëndësishme të mos lejohet zhvillimi i ndeshjeve të tilla në territorin e Kosovës", ka thënë Ademi. Ndërsa klubi serb ka reaguar, duke e vlerësuar të padrejtë

vendimin e shtetit të Kosovës për moslejimin e zhvillimit të kësaj ndeshje. "Ne erdhëm për të luajtur futboll dhe të bëjmë sport, por kjo na u mohua. Pavarësisht faktit se e kishim rekomandimin nga FIFA për ta zhvilluar ndeshjen ndaj Trepçës në Mitrovicë, institucionet e Kosovës e injoruan këtë keshillë. Kur iu afroam pikës kufitare për të kaluar andej, Policia e Kosovës arriti dhe na tha se e kishim të ndaluar të futeshim në territorin e Kosovës. Kur e pyetëm përse, na tha se është vendim i Qeverisë së Kosovës. Nuk kishte shpjegime të tjera", është thënë në reagimin e skuadrës së Crvena Zvezdës.

Prekazi e Kastrati: Ndaj Shqipërisë do të luajmë me krenari dhe përgjegjësi

PRISHTINË, 9 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses U21, Rafet Prekazi dhe futbollisti Lirim Kastrati kanë shprehur optimizëm për ndeshjen e radhës në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian që do ta zhvillojnë më 15 tetor në Elbasan kundër Shqipërisë.

"Dardanët" e rinj nisën përgatitjet për këtë ndeshje, kurse trajneri Rafet Prekazi ka thënë se ekipi i tij do ta vazhdojë serinë e paraqitjeve të mira. Ai ka pranuar se nuk ka qenë dëshira e tij të jetë në të njëjtin grup me Shqipërinë. "Kjo do të jetë një ndeshje si të gjitha të tjerat. Nuk merrem shumë me ekipin

kundërshtar sa iu përket lëndimeve sepse edhe ne kemi problemet tona. Futbollit modern është agresiv dhe në një futboll të tillë lëndimet janë të mundshme. Sido që të jetë, edhe në këtë ndeshje do të shkojmë të luajmë me krenari për këtë shtet dhe me përgjegjësi të madhe. Kur Shqipëria shkoi në Kampionatin Evropian, nëntë lojtarë kanë qenë me prejardhje nga Kosova dhe të gjithë jemi gëzuar bashkërisht. Pra, nuk ka ndarje mes nesh", ka thënë Prekazi, i cili e ka pranuar se nuk ka dashur të jetë Kosova në grup të njëjtë me Shqipërinë. "Le të fitojë

ai që e ka ditën dhe të jetë lojë korrekte. Mendoj se Kosova me paraqitjet që po i bën dhe me kualitetin që ka do të jetë një mini-Kroaci", ka shtuar Prekazi. Ndërkaq Lirim Kastrati e vlerësoi duelin me kuqezinjët të veçantë, duke pasur parasysh se ballafaqohen vëllezërit e një kombi, mirëpo ka thënë se në fushë do ta japin maksimumin për fitore. "Mendoj se do të jetë një ndeshje e mirë sepse është e veçantë pasi të gjithë që zbrisim në fushë do të jemi shqiptarë. Ne do ta japim maksimumin për të pasur rezultat të mirë dhe për të ecur përpara në

grupin tonë. Edhe vetë kam luajtur me Shqipërinë me U17 dhe kam shokë atje, por kur hyj në fushë nuk mendoj asgjë tjetër përveç lojës dhe do ta jap maksimumin për shtetin tim", ka thënë Kastrati. Ndeshja ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës luhet më 15 tetor.



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Florjan Smakioq, Ardit Nika, Ardit Hyseni, Enit Sadiku, Leonat Vitija, Kreshnik Hajrizi, Leard Sadiu, Lirim Kastrati, Fuad Rahimi, Besford Kolgeci, Valon Hamdiu, Roni Gashi, Gezim Pepsi, Ismet Lushaku, Eris Abedini, Blend Baftiu, Arber Hoxha, Qëndrim Kameraj, Blendi Idrizi, Arbnor Muja, Valdrin Mustafa, Mirlind Daku.

Juventus dominon në formacionin e dekadës në Serinë A

TORINO, 9 TETOR - Portali i njohur sportiv "Goal.com" ka përpiluar formacionin më të mirë të dekadës në kampionatin italian, Serie A. Elita e futbollit italian në dekadën e fundit është dominuar nga Juventus, i cili ka fituar tetë

nga dhjetë titujt e fundit në kampionat. Janë pikërisht futbollistët e "Zonjës së Vjetër" ata që dominojnë në formacionin e dekadës. Gianluigi Buffon në portë dhe treshja e mbrojtjes, Giorgio Chiellini, Leonardo

Bonucci dhe Andrea Barzagli, janë përfshirë në këtë formacion. Në këtë formacion bënë pjesë edhe sulmuesi Gonzalo Higuain, por edhe ish-mesfushori Andrea Pirlo. Pjesa e formacionit gjenden edhe disa yje të

Napolit si Marek Hamsik dhe Jose Callejon, ndërsa Senal Lulij bën pjesë nga Lazio dhe Antonio Di Natale i Udineses. Pjesë e këtij formacioni është edhe ish-ylli i Romës dhe Interit, Radja Nainggolan.



Veseli dhe Trashi: Synojmë fitoren ndaj Turqisë



TIRANË, 9 TETOR - Ditën e premte Kombëtarja shqiptare do të luajë ndaj Turqisë sfidën e radhës së kualifikueseve të "Euro 2020", një përballje kjo që shihet nga kuqezinjtë si një përballje vendimtare për ecurinë e skuadrës sonë përfaqësuese në këtë fushatë dhe për shpresat e saj për një kualifikim të mundshëm për në evropianin e vitit të ardhshëm, që u theksua edhe nga Frederik Veseli. "Ndeshja me Turqinë ka shumë rëndësi sepse e dimë se kemi mundësi të bëjmë hapa para nëse fitojmë. Ne do ta synojmë fitoren.

Besoj dhe shpresoj që ta mundim Turqinë e kemi bërë në miqësoren në Antalia. Ende synojmë kualifikimin në Evropian. Nuk jemi ende matematikisht të eliminuar dhe një fitore ndaj Turqisë mund t'i rrisë shanset. Suksesin ndaj Islandës na ka ndihmuar dhe besoj se mund ta shfrytëzojmë lojën e mirë me Islandën edhe në ndeshjen me Turqinë", ka thënë Veseli. Në të njëjtën linjë me Frederik Veselin ishte edhe Lorenc Trashi që grumbullohet për të tretën herë me kombëtaren shqiptare. "Do të kemi një

ndeshje të fortë sepse Turqia luan në shtëpinë e vet përballë publikut të vet. Duhet ta japim maksimumin tonë për ta arritur objektivin tonë që është fitorja sepse na jep shpresë për të parë më lart. Duhet t'i shfrytëzojmë pikat e dobëta të kundërshtarit, në ndeshje të tilla 2-3 shanse të jepen dhe ne duhet t'i shfrytëzojmë", ka deklaruar Trashi. Sfidat mes Turqinë do të luhet ditën e premte në "Fenerbahçe Ülker Stadium", ndërkohë që tri ditë më pas kuqezinjtë do të luajnë me Moldavinë, edhe kjo një ndeshje mysafire.

Marquez: Do t'i thyej rekordet e Rossit

CERVERA, 9 TETOR - Marc Marquez e fitoi në Tajlandë titullin e tetë kampion në karrierën e vet (6 në Moto GP), duke qenë kështu vetëm një titull larg një legjende të këtij sporti si Valentino Rossi. Dy pilotët që nuk kanë një marrëdhënie shumë të mirë mes tyre. Piloti spanjoll i Hondas shprehet se një ditë do ta mposhtë rivalin e tij jo vetëm në pistë, por edhe në rekorde. "Unë kam besim se mund të arrij ta kap atë që e ka arritur Rossi. E kam mundur në pistë, tani do ta mund në statistika", ka thënë Marquezi, duke shtuar se: "Rossi mbetet një legjendë, një frymëzim për ne që jemi në këtë sport, por rekordet janë bërë për t'u thyer.



Gjithsesi, ka ende kohë për të shkuar te shifrat e vendosura nga Rossi. Tani mendoj për ta

mbyllur këtë sezon me të tjera fitore dhe duke hedhur bazat për 2020-n".

SHKURT

Vetteli: Askush nuk me mund në Suzuka

Piloti gjerman Sebastian Vettel beson se do të triumfojë ditën e diel në garën e Çmimit të Madh të Japonisë. "Pa asnjë dyshim, Suzuka është pista që pëlqej më shumë në Botërorin e Formulës 1. M'i kujton ato pistat lodër që përdornim kur ishim fëmijë. Nuk është një pistë banale. Sidomos pjesa e parë e saj është mjaft tërheqëse. Mendoj se me makinën Ferrari që kemi në dispozicion këtu do të fitojmë. Jam i bindur se fitoren këtë herë nuk ma heq njeri, as rivalët e as urdhrat e skuadrës", ka thënë piloti i Ferrarit. Në fund, piloti gjerman ka një dedikim për tifozët japonezë. "Janë të jashtëzakonshëm. I gjen aty shumë orë para se të mbërrijnë pilotët dhe të transmetojnë dashuri e respekt. Kjo është fantastike. Ia vlen të garosh për ta".

Pioli: Duhet të kualifikohemi në Ligën e Kampionëve

Stefano Pioli është prezantuar si trajner i ri i skuadrës së Milanit. Pioli do të zëvendësojë Marco Giampalon, i cili u shkarkua për shkak të rezultateve të dobëta me skuadrën kuqezi. "Jam entuziast për këtë aventurë. Më kontaktoi një nga klubet më prestigjioze në botë. Jam i bindur se mund të bëj një punë të shkëlqyer, së bashku me drejtuesit që besuan tek unë. Kam respekt për tifozët dhe ata kanë të drejtë të kritikojnë. Kemi dhjetë ditë kohë për ta përgatitur skuadrën në mënyrë të shkëlqyer", ka thënë Pioli. "Ne do të luftojmë për t'i arritur objektivat e klubit. Vështirësitë janë të mëdha, por duhet të përballemi me to dhe t'i kalojmë. Ne duhet të punojmë shumë pasi kemi nevojë për intensitet dhe cilësi. Ndihej si mësues. Kemi shumë lojtarë të mirë dhe duhet t'i përmirësojmë ata. Duhet t'i fitojmë tifozët. Duhet të kualifikohemi në Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Pioli.

Messi: Është gënjeshtër që nuk e kam dashur Griezmannin te Barça

Lionel Messi ka hedhur poshtë zërat se ishte kundër transferimit të Antoine Griezmann në skuadrën e Barcelonës. Sulmuesi francez iu bashkua kampionëve të La Ligas për një shumë prej 120 milionë eurosh përpara sezonit 2019/20. "Natyrisht është një gënjeshtër që nuk e kam dashur Griezmannin. Vitin e kaluar thashë që ai ishte një nga më të mirët dhe më të mirët janë gjithmonë të mirëpritur. Unë gjithashtu kam dashur që Neymari të vijë për të njëjtën arsye, sepse ai është i ndryshëm, një nga më të mirët, dhe ta kesh atë këtu do të kishte qenë i rëndësishëm për qëllimet tona", ka thënë Messi.

Pogba gjithnjë e më larg Unitedit

Paul Pogba vazhdon të jetë në dyshim për të ardhmen. Francezi ka qenë dhe mbetet një temë e nxehtë pasi e ardhmja e tij nuk është mbyllur në asnjë çast dhe si rezultat i kësaj francezi mbetet me një këmbë larg Manchester Unitedit. Pogba ka kërkuar 30 milionë euro pagë sezonale, një pagë e përafërt me atë që përfiton Cristiano Ronaldo te Juventus. Kjo kërkesë e Pogbas nuk është pritur mirë nga drejtuesit e "dajve të kuq", më shumë ngjan si një tentativë e fundit e Pogbas për t'u larguar. Mesfushori francez ka shprehur publikisht dëshirën për t'u larguar, por mbetet peng i kontratës e cila i skadon më 2021. Mediet britanike parashikojnë se Pogba do të mund të largohet nëse Real Madridi ose Juventus ofrojnë shumën e kërkuar nga Unitedi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 515/1
Dt. 09.10.2019

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 07/2017, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur si dhe në bazë të kërkesës së shkollës shpall:

RI- SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj – paralelet e ndara në Prishtinë dhe Pejë

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka zhvilluar nivelin e 5 (pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Qendrën e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" dhe në këtë vit shkollor ky kualifikim do të ofrohet në paralelet e ndara në Qendrën Burimore "Përparimi" – Prishtinë dhe në Qendrën Burimore "Xheladin Deda" - Pejë.

Qendrën e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	4 (katër) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin, "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" - 2 (dy) mësimdhënës/e për paralelen në Prishtinë - 2 (dy) mësimdhënës/e për paralelen në Pejë	Vendi i lirë për një (1) vit shkollor)

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimin

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me standartin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;
- Bëhë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes së cilësisë dhe transferimit e njohurive dhe shkathtësive adekuata te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veprat adekuata juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;

- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

Kualifikimi, shkathtësitë dhe dokumentacioni i kërkuara:

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

Procedurat e konkurrimit

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet për dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHT-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p.n, Prishtinë. Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Për informata të hollësishe mund të kontaktoni xhevahire.pllana@rks-gov.net nr.tel 038 200 20 351, prej orës 08:00-16:00.



Lagja Ulpianë | Rr. Zija Shemsiu | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

FTESË PËR OFERTIM

IPKO Telecommunications LLC njofton të interesuarit se bën shitjen e kabllove koaksiale dhe fibrave të përdorura.

Dokumentacioni me kushtet e përgjithshme për shitjen e veturave mund të tërhiqet prej datës **08 deri me 11 Tetor 2019** në ndërtesën e IPKO-s në Rr. Zija Shemsiu nr.34, Ulpianë – Prishtinë.

Oferta duhet të dorëzohet në: IPKO Telecommunications LLC, Rr. Zija Shemsiu nr. 34, 10000 Prishtinë, Kosovë, jo më vonë se **18 Tetor 2019 në ora 14:00h.**

Nëse keni ndonjë pyetje sa i përket ftesës për ofertim, ju lutem na shkruani në adresën elektronike procurement@ipko.com

Me respekt

IPKO Telecommunications
Rr. Zija Shemsiu nr.34 Ulpiane
procurement@ipko.com

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Elena Gjika"
Komuna: Skenderaj
Data: 10.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/108-CS/1.2	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie (3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Elena Gjika" Makermal, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: fushën e përdorimit të teknologjisë.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Elena Gjika" Makermal, Skenderaj, më së largu deri më datën; 18.10.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Ardita Nura
Telefoni: 044/ 412 001
E-maili: ardita.nura@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Halit Geci"
Komuna: Skenderaj
Data: 10.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/112 - ESIP/SDG/112-	Blerja e mjeteve të teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës: Shfmu "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Lap top 4 copë
- Projektor 2 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 1 kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: Shfmu "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj, më së largu deri më 18.10.2019

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Shefshet Geci
Telefoni: 044/ 957 047
E-maili: sh.f.halit_geci@hotmail.com

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Halit Geci"
Komuna: Skenderaj
Data: 10.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/112-CS/1.2	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie (3

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: përdorimit të teknologjisë.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj, më së largu deri më datën; 18.10.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Shefqet Geci
Telefoni: 044/957-047
E-maili: sh.f.halit_geci@hotmail.com

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "DITURIA" Ivajë
Komuna: Kaçanik
Data: 09.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/148-CS/1.3	Trajnim: Zbatimi i TI në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "DITURIA", Ivajë Kaçanik.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Zbatimi i Teknologjisë Informative në mësimdhënie (World, Exel dhe Power Point)

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "DITURIA", Ivajë Kaçanik., më së largu deri më 22.10.2019.

4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Nexhadi Luta
Telefoni : 044 224 878
E-mail: nexhadiluta@hotmail.com



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



NJOFTIM I SHITJES ME ANKAND PUBLIK
NOTICE OF PUBLIC AUCTION SALE
OBAVEŠTENJE O PRODAJU U JAVNU LICITACIJU

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, Mbledhja e Detyruar e Tatimit, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit.

Under the Law 03/L-222, Article 34 Enforcement Collection of tax, the property described below has been seized for nonpayment of taxes due

Na osnovu Zakona Br.03/L-222 Član 34 Prinudna Naplata Poreza, dole navedena imovina je zaplenjena zbog ne naplateporeza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të hapura sikurse është rregulluar në “Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2010, Neni 37.

The property shall be sold by sealed bid auction as provided on “Law 03/L-222 on Tax Administration and Procedures”, Article 37

Imovina prodace se licitacijom zatvorenim ponudama kako je to regulisano u Zakonu Br. 03/L-222, o Poreskoj Administraciji i Procedurama, Član 37.

DATA E SHITJES/DATE OF SALE/DATUM PRODAJE: **25.10.2019 (E Premte)**

KOHA E SHITJES/TIME OF SALE/VREME PRODAJE: **10:00**

VENDI I SHITJES/MESTO PRODAJE: **Depoja e ATK-së (mbrapa Auto Sallon REFORMA), në Shkabaj – PRISHTINË**

Përshkrimi i pasurisë/Description of property/ Opis imovine:

Nr.	Përshkrimi i Artikullit	Njësia	Sasia	Vërejtje	Gjatësia	Sandëku	Kapakat	Pllaka e Punës	Lavabo	Pajisje tjetër	Çmimi Fillestar
1	KUZHINA OMEGA	Komplet	1	ME 22 ELEMENTE	5.4 m	Ivericë	Ivericë	laminat	N/P	N/P	1,155.00
2	KUZHINA ZANA 1	Komplet	1	ME 7 ELEMENTE		Ivericë	Ivericë	N/P	N/P	N/P	360.50
3	KUZHINA FENIX	Komplet	1	ME 7 ELEMENTE	3.8 m	Ivericë	Ivericë	laminat	N/P	N/P	535.50
4	KUZHINA VENERA	Komplet	1	ME 12 ELEMENTE	5.2 m 1.6 m Shank	Ivericë	mdf+pvc	kerock	Kerock	Raf rotulluese	1,260.00
TOTAL:											3,311.00€

Nr.	Përshkrimi i Artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi Fillestar
1	FURRA (SHPORET) ARISTON U700E-46X	Copë	1	105.00
2	FURRA (SHPORET) OIM 22301X-970 - xhami i kapakut i prishur	Copë	1	70.00
3	ASPIRATOR	Copë	2	81.20
4	LLAVABO KOLPA	Copë	28	1,378.54
5	LLAVABO BLANCO	Copë	32	1,792.00
6	PLLAKA VRH 60X-730	Copë	1	210.00
7	PLLAKA KRA 640X-551	Copë	1	217.00
8	SIFONA	Copë	23	144.90
9	NGJITËS 1kg dhe 5kg	KUTI	26	286.79
10	PVC FOLIJA 0.4mm - 144 metra	Rrollne	144	147.84
11	LLAVABO KOLPA 362	Copë	14	1,176.00
12	PLLAKA POLIMER GRANITI / AKRIL	Copë	76	
12.1.	(PLLAKA POLIMER (KOREAN) 12mm)	Copë	10	2,800.00
12.2.	(PLLAKA POLIMER (KOREAN) 8mm)	Copë	23	3,542.00
12.3.	(PLLAKA POLIMER (KOREAN) 6mm)	Copë	43	3,511.20
13	PLLAKA PUNE 410X60X4	Copë	19	239.40
				15,701.87€

Nr.	Përshkrimi i Artikullit	Njësia	Sasia	Vërejtje	Çmimi Fillestar
1	VETURA XHIP HYUNDAI SANTA FE 2.0 CRDI, 5 DYER, DIESEL MANUAL, NE GJENDJE JO TE MIRE TEKNIKE	Copë	1	DEFEKT	2,000.00€

Kushtet e pagesës: Kërkohet pagesa e tërësishme me pranimin e ofertës më të lartë. Të gjitha pagesat duhet të bëhen me transfer bankar në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Payment terms: Full payment required upon acceptance of highest bid. All payments must be made by bank transfer to Budget of Republic of Kosovo.

Uslovi naplate: Traži se celokupna naplata primenjem najveće ponude. Sve isplate treba da se vrše bankarskim transferom u Budžet Kosova.

Informata shtesë lidhur me gjëndjen e mallrave dhe shikimin e tij mund të kontaktoni zyrtaret e autorizuar të ATK-së. në tel. 044737952, 045485555/ prej orës 08.00-16.00.

For additional information with regard of goods' conditions and their review can be contacted the authorized TAK officials on tel. 044737952, 045485555, from 08:00 a.m. – 04:00 p.m.

Za dodatne informacije u vezi uslova robe i njihovo razmatranje se može kontaktirati nadležne PAK zvaničnike tel. 044737952, 045485555, od 08:00 - 16:00.

Nënshkrimi i Drejtorit Rajonal: _____

Data: 07.10.2019



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës
Drejtoria Për Arsim dhe Edukim



Nr: 11/2502
Më:09.10.2019

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2019 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës
Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHHFMU" Ruzhdi Xhyliçi" në Marali	Edukatore	Vendi i lirë	1	20

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- certifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës edukatore kërkohet kualifikimi me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përparë.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web-faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **09.10.2019 më datën: 23.10.2019**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Betoni - & MB" Sh.p.k Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e gypave dhe elementeve tjera nga betoni në Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.11.2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Dardani Center" magjistratja Ferizaj-Gjilan do të organizohet debat publik nga kompania "Betoni - & MB" Sh.p.k Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e gypave dhe elementeve tjera nga betoni në Ferizaj.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "APOLLONIA-AC" Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810190562 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka "APOLLONIA-AC" D.O.O, doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 810190562 i ujdno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti imaju obaveze I potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "APOLLONIA-AC" L.L.C, has come to the decision to quit its business with registry 810190562 -The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage-mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Sot u bënë pesë vite nga ndarja fizike me bashkëshortin, babin, vëllain, gjyshin, vjehrrin, xhaxhain, tonë të dashur dhe të paharruar



LATIF (UKSHIN) TAHIRI

11.04.1947 - 10.10.2014

Sot u bënë pesë vite nga ndarja fizike baba, pa buzëqeshjen tende, ngrohtësinë tende, fjalët e tua prej një babai shembullor dhe me virtytet, udhërrëfyes i jetëve të tona.

Ne do të duam përgjithmonë, do të përkujtojmë brez pas brezi dhe do të bartim gjeneratë pas gjeneratë fjalët dhe vlerat e tua që ja kushtove familjes, kombit dhe institucionit arsimor...

Faleminderit që na le faqebardhe, ballëhapur dhe krenarë.

Ti jeton përtej vdekjes . . .

Mburremi me ty Baba!

Me mall të pashuar, Familja Tahiri nga fshati Klinë e Epërme, Skenderaj.